



2010

RAPORT VJETOR



© 2011

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.
Adresa : Rruga "Dora D'Istria", Nr. 10, P.O.Box. 8363, Tiranë
Tel : +355-4-2251355 / 6
Faks : +355-4-2250686
E-mail : amf@amf.gov.al
URL : www.amf.gov.al

Përmbajtja



Fjala Përshëndetëse e Kryetares	6
PJESA I	
AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI	7
Kapitulli 1	
Organizimi i AMF	
1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore	7
1.2 Menaxhimi dhe organizimi	8
1.3 Buxheti dhe financimi	15
Kapitulli 2	
Aktiviteti i AMF	18
2.1 Aktiviteti rregullues	18
2.2 Aktiviteti licencues	25
2.3 Aktiviteti mbikëqyrës	32
2.4 Teknologjia e informacionit	46
2.5 Bashkëpunimi institucional	49
2.6 Integrimi Evropian	56
2.7 Marrëdhëniet me publikun dhe transparencja	59
Kapitulli 3	
Mbrojtja Konsumatorit	63
PJESA II	
TREGJET E MBIKËQYRURA	66
II.1 Tregu i sigurimeve	66
II.2 Tregu i letrave me vlerë	73
II.3 Tregu i pensioneve private vullnetare	76
SHTOJCA	79

Fjala Përshëndetëse e Kryetares



Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF

Të nderuar Lexues të Raportit Vjetor 2010,

Ky Raport paraqet veprimtarinë dhe rezultatet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) gjatë vitit 2010, në ushtrimin e detyrave rregullatore dhe mbikëqyrëse të tregjeve financiare jo-bankare. Përgatitja dhe paraqitja e raportit vjetor përfaqëson, tashmë, jo thjesht zbatim të një detyrimi ligjor, por një mjet të rëndësishëm komunikimi midis AMF dhe publikut, si dhe një instrument të vlefshëm për përgjegjshmërinë e AMF-së.

Gjatë 12 muajve të kaluar, AMF ka punuar në një klimë ekonomike dhe financiare ende të brishtë, si pasojë e ndikimit të krizës së përgjithshme globale. Për pasojë, parimi kryesor i punës tonë ka qenë ushtrimi i mbikëqyrjes vigjilente, e nevojshme për të nxitur dhe mbështetur qëndrueshmërinë financiare.

Gjatë këtij viti është arritur progres i rëndësishëm në nismat dhe projektet afatmesme të AMF-së. Ndër to, dua të veçoj prezantimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun, si një metodologji me filozofi të re. Në vijim të punës së nisur prej 3 vjetësh, gjatë vitit 2010, AMF ka bërë një punë intensive për trajnimin e stafit dhe ka bashkëpunuar ngushtë me tregun.

Forcimi i mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare, gjatë vitit 2010 është konkretizuar me miratimin e një sërë aktesh nënligjore në të gjitha fushat e mbikëqyrura. Në çdo rast përmirësimet dhe plotësimet rregullatore kanë për synim rritjen e shkallës së përafrimit të legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Evropian, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe përmbushjen e standardeve dhe kriterëve ndërkombëtare të zbatueshme për tregjet financiare jo-bankare.

Bashkëpunimi ndërkuftar me institucionet homologe, gjatë vitit 2010, ka hyrë në një fazë të re zhvillimi me realizimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë.

Përpjekje të vazhdueshme janë bërë në përmbushje të objektivit të mbrojtjes konsumatore. Gjatë vitit 2010, botimet tona janë shtuar në numër dhe larmishmëri, duke i shërbyer më mirë grupeve të ndryshme të interesit. Faqja e internetit e Autoritetit ofron një portal eficient të dhënies të informacionit, të organizuar dhe përshtatur për grupëpërdorues të ndryshëm.

Gjatë vitit 2010, AMF zhvilloi veprimtarinë e vet në ambientet e reja të rikonstruara, të cilat ofrojnë kushte pune bashkëkohore dhe infrastrukturë moderne profesionale e sociale.

Nuk ka dyshim, se klima ekonomike dhe reformat që zhvillohen në shkallë globale dhe në vend paraqesin në mënyrë të vazhdueshme sfida për AMF-në. Nga ana tjetër, motivimi dhe kontributi i stafit të AMF-së, bashkëpunimi dhe mbështetja e sinqertë që kolegët e Bordit kanë dhënë, kanë mundësuar përmbushjen e objektivave të AMF-së, brenda burimeve financiare të buxhetuara. Shpreh mirënjohjen time për stafin dhe kolegët e Bordit që mundësuan këto arritje, të cilat shënuan një tjetër vit të suksesshëm në veprimtarinë e AMF-së.

Duke shpresuar që raporti të sjellë informacion të dobishëm dhe me interes.

Me konsideratë

Kryetare

PJESA I

AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI



Kapitulli 1

Organizimi i AMF

- *Mbrojmë konsumatorët*
- *Promovojmë tregjet*
- *Zbatojmë ligjin*

1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03. 07. 2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si një ent rregullator i konsoliduar për të mbikëqyrur tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri. AMF si institucion juridik publik i pavarur, për veprimtarinë që ushtron në përputhje me këtë ligj, raporton në Kuvend.

SUBJEKTE të mbikëqyrura

- Shoqëritë e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës
- Shoqëritë e risigurimit
- Ndërmjetësit e sigurimeve
- Bursa dhe tregjet e tjera të letrave me vlerë
- Ndërmjetësit financiarë të letrave me vlerë
- Shoqëritë administruese
- Fondet e investimit dhe shoqëritë e investimit
- Fondet e pensionit
- Kujdestar, Depozitar dhe Regjistrar i letrave me vlerë
- Profesionistë të fushave përkatëse

Misioni

Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore.

Objektivat

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve
- Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jo-bankare
- Sigurimi i respektimit të ligjit

Funksionet themelore të AMF-së

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja e:

- tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari,

- tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg,
- tregut të pensioneve vullnetare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve vullnetare, të ofruara nga subjektet e licencuara për të operuar në këtë treg,
- veprimtarive të tjera financiare jo-bankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës, që në vijim do të quhen “tregje financiare jo-bankare”.

Funksionet bazë rregullative-mbikëqyrëse të AMF-së, parashikohen kryesisht në nenet 2 dhe 13 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe përkatësisht në ligjet e sektorëve të mbikëqyrur (Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”).

Kuadri i ri ligjor në fushën financiare jo-bankare ka konsoliduar më shumë funksionet rregullative dhe mbikëqyrëse të AMF-së. Këto ligje përmbajnë dispozita të veçanta, të cilat japin një përcaktim më të qartë të funksioneve apo kompetencave që ka Autoriteti.

1.2 Menaxhimi dhe organizimi

Bordi i AMF-së

Bordi i AMF-së është organi drejtues dhe vendimmarrës i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Të gjithë anëtarët e Bordit mandatohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me afate të shkallëzuara për mandatin e parë, që përcaktohen nominalisht. Bordi i AMF-së, ka përbërjen e mëposhtme:

▪ Elisabeta GJONI	<i>Kryetare</i>	▪ Diana LAMANI ³	Anëtare
▪ Keler GJIKA ¹	<i>Nënkryetar</i>	▪ Saimir SALLAKU ⁴	Anëtar
▪ Ermela GUXHOLLI ²	<i>Nënkryetare</i>	▪ ----- ⁵	Anëtar
▪ Miranda RAMAJ	<i>Anëtare</i>		

Shënim - ¹ Larguar nga Autoriteti në janar 2010, statusi vakant.
² Mbaruar mandati në shtator 2010, vazhdon në detyrë.
³ Mbaruar mandati në shtator 2010, vazhdon në detyrë.
⁴ Mbaruar mandati në shtator 2009, vazhdon në detyrë.
⁵ Statusi vakant.



Gjatë vitit 2010, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka zhvilluar 12 mbledhje, ku janë marrë gjithsej 139 vendime, në përmbushje të funksioneve rregullative, mbikëqyrëse dhe atyre institucionale.

Autoriteti ka marrë një sërë vendimesh me rëndësi në kuadër të forcimit të mbikëqyrjes, zhvillimit e rregullimit të mëtejshëm të tregut financiar jo-bankar. Për vitin 2010, ndër vendimet më të rëndësishme të bordit, mund të përmendim ato që lidhen me gjallërimin e tregut nëpërmjet licencimit të operatorëve në fusha të ndryshme në treg si: licencimin e ndërmjetësve në sigurime, vlerësuesve të dëmeve, shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve, brokerave fizikë dhe shoqërive të brokerimit, si dhe plotësimin e përshtatjen e kuadrit rregullator në të gjitha tregjet e mbikëqyrura por duke vënë theksin sidomos në fushën e pensioneve private.

Vendimet e bordit kanë mundësuar realizimin e një mbikëqyrje efektive të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe atij të pensioneve private. Vendimet e lidhura me funksionet mbikëqyrëse përshijnë masa korrektive dhe sanksione, që kanë synuar parandalimin e situatave jo të përshtatshme, si dhe eliminimin e shkeljeve dhe përmirësimin e tregut financiar jo-bankar.

Kompetencat Kryesore të Bordit të AMF-së

1. Harton rregullat për përshkrimin dhe qëllimin e punës së çdo departamenti dhe njësie.
2. Harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së tij.
3. Harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara në ligj.
4. Shpërndan udhëzues të shkruar për interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore.
5. Lëshon, refuzon, pezullon apo heq licencat për ushtrimin e veprimtarisë në tregun financiar jo-bankar.
6. Kufizon ose ndalon investimet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, kur ato nuk janë në përputhje me raportet rregullatore apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë.
7. Shqyrton kushtet e kontratës së sigurimit, para se ato të hidhen në treg nga operatorët.
8. Miraton pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit.
9. Miraton dhe shpërndan standarde kontabël dhe formatet e njoftimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit.
10. Përcakton politikat e mbikëqyrjes, të kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura dhe të zhvillimit të tregut financiar jo-bankar.
11. Miraton listën e ekspertëve kontabël për shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jo-bankare.
12. Miraton çdo vit raportin për industrinë, në lidhje me gjendjen dhe perspektivën e




Elisabeta Gjoni
Kryetare



Ermela Guxholli
Nënkryetare



Miranda Ramaj
Anëtare



Diana Lamani
Anëtare



Saimir Sallaku
Anëtar

- tregut financiar jo-bankar.
13. Miraton manuallet e inspektimit.
 14. Sipas ligjit, merr vendim për fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikëqyrura dhe emëron likuidatorin.
 15. Miraton projektbuxhetin dhe raportin vjetor të AMF-së.
 16. Merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit.
 17. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.
 18. Miraton politikën e pagave dhe të shpërblimeve të stafit të AMF-së.
 19. Miraton rregulla për emërimin dhe shkarkimin e stafit.

Struktura organizative e AMF-së



AMF - Departamenti i Licencimit e Monitorimit

Struktura e Autoritetit miratohet nga i Kuvendi i Shqipërisë me propozimin e Bordit të AMF-së. Edhe gjatë vitit 2010, Autoriteti vazhdoi të funksionojë sipas strukturës dhe organikës së miratuar në bazë të Vendimit të Kuvendit, nr. 98, datë 30.04. 2007 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.

Struktura aktuale e organizimit të Autoritetit mundëson një hierarki të përshtatshme për stafin e AMF-së dhe lejon mbulimin e të gjitha funksioneve që AMF kryen. Organizimi në


katër departamente kryesore dhe disa drejtori krijon një ndarje të drejtë të përgjegjësive dhe lehtëson komunikimin midis njësive përbërëse.

Organika e AMF-së, e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është 58 punonjës. Numri i punonjësve për vitin 2010 nuk u kushtëzua nga ligji i Buxhetit të Shtetit, pasi veprimtaria e AMF-së për vitin 2010, u realizua me fonde tërësisht të krijuara nga të ardhurat e aktivitetit të saj.


Zhvillimet e fundit të teknologjisë e informacionit, në mbështetje të objektivave ambicioze të zhvillimit të tregut dhe përafrimit të mbikëqyrjes me standardet ndërkombëtare, si dhe vendosja në godinë më vete e institucionit, kërkon përshtatjen e disa elementëve të strukturës, për të cilat shpresojmë, që AMF do të gjejë mirëkuptimin dhe mbështetjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvend.




Struktura sipas njësive



Struktura sipas profesionit



Struktura e stafit teknik të AMF sipas grupmoshës





Stafi i AMF-së 2010

Politikat e Burimeve Njerëzore

Qëllimi kryesor në fushën e burimeve njerëzore është zhvillimi i profesionalizmit të punonjësve dhe motivimi i tyre për arritjen e objektivave të institucionit.

Në planin afatshkurtër vëmendja e sektorit të burimeve njerëzore u përqendrua në:

- nxitjen dhe motivimin e punonjësve
- trajnimin e mëtejshëm e sa më të plotë të punonjësve
- punësimin e burimeve më cilësore njerëzore

Trajnimi dhe motivimi i punonjësve synon nxitjen e dëshirës së punonjësve për të punuar dhe rritjen e cilësisë së punës.

Në funksion të kësaj politike, AMF për shkak të disa kufizimeve ligjore nuk arrin të përdorë maksimalisht mjetet dhe politikat stimuluese për tërheqjen dhe mbajtjen e kapaciteteve profesionale edhe pse statusi që institucioni ynë ka, burimet specifike të financimit, krijojnë mundësi për nxitje më të madhe të punonjësve që aplikojnë ekspertizë të lartë teknike në punë.

Një ndikim të madh në këtë aspekt, për vitin 2010, shënoi përfundimi i rikonstruksionit të mjediseve të reja të AMF-së, duke krijuar për stafin kushte bashkëkohore dhe infrastrukturë moderne në mjedisin profesional dhe social të punës.

Po ashtu, procesi i vlerësimit të arritjeve individuale në punë, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese, ka dhënë ndikimin e tij në rritjen e efektivitetit në punë.




Procesi i rekrutimit

Punësimi i burimeve sa më të afta njerëzore vazhdoi të jetë përparësi në kuadrin e politikave të burimeve njerëzore edhe gjatë vitit 2010, pasi cilësia e tyre kushtëzon në mënyrë të padiskutueshme rendimentin dhe cilësinë e punës në institucion. Nëpërmjet procedurave aktuale të rekrutimit është kryer punësimi i burimeve cilësore njerëzore që ofrojnë rritje cilësore të punës, me synim përmbushjen dhe realizimin e objektivave të institucionit.

Gjatë periudhës raportuese, u rekrutuan 4 punonjës të rinj, bazuar në procedurat e rekrutimit, të cilat lejojnë një përzgjedhje të kënaqshme të kandidatëve që posedojnë njohuri dhe aftësi shumë të mira profesionale dhe etikë e integritet të lartë në punë. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar punësimit të të rinjve që janë diplomuar apo kualifikuar me rezultate të larta. Një sjellje e tillë, mundëson pasurimin e mjedisit profesional me përvoja të reja dhe që përbëjnë një burim real zhvillimi të punës në Autoritet.

Struktura e stafit teknik sipas diplomimit



Kualifikimi profesional

Gjatë vitit 2010, AMF i ka kushtuar vëmendje objektivit për rritjen e kualifikimit profesional të punonjësve sipas profileve dhe pozicioneve përkatëse. Procesi i kualifikimit profesional merr rëndësi të veçantë, në kushtet e zhvillimit të shpejtë të tregut shqiptar financiar jo-bankar (kryesisht të tregut të sigurimeve), duke sjellë përvojën, problemet dhe zhvillimet më të fundit të tregjeve dhe mbikëqyrjes së sigurimeve perëndimore.

Aktivitetet e realizuara për vitin 2010, brenda dhe jashtë vendit, kanë konsistuar në trajnime, seminare, konferenca, takime, si dhe vizita në shkëmbimin e eksperiencave e përvojave më të mira profesionale, mbështetur në asistencën e institucioneve prestigjioze ndërkombëtare në fushën financiare si: Banka Botërore,



Gjatë zhvillimit të testimit



Kursi i aktuaristikës organizuar nga FSVC

Këshilli i Evropës, si dhe shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve IAIS, IOSCO, IOPS, NAIC, etj.

Shifrat tregojnë se në vitin 2010 rreth 72% e stafit teknik të AMF-së ka marrë pjesë aktive në seminare, trajnime, e konferenca, të lidhura me fushat respektive.

AMF në funksion të politikës së financimit të specializimeve në sektorë që lidhen drejtpërsëdrejti me funksionet mbikëqyrëse dhe rregulluese të tregut financiar jo-bankar, vazhdoi edhe gjatë vitit 2010 mbështetjen e 3 punonjësve për ndjekjen e kursit të trajnimit në fushën e aktuaristikës, kurs i cili, organizohet nga FSVC dhe bazohet në praktikën më të mira të Fakultetit dhe Institutit të Aktuarëve në Britaninë e Madhe. Një tjetër kurs i rëndësishëm që synon rritjen e aftësive profesionale të punonjësve dhe të cilësisë së punës është kursi për titullin Analist Financiar i Certifikuar (CFA), i cili ndiqet nga 2 punonjës të Autoritetit.

Auditi i brendshëm

Funksioni

Njësia e Auditit të Brendshëm në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare kryen funksionin e saj në zbatim të rregullave të përcaktuara në Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 345, datë 01.06.2004 “Për Manualin e Auditimit të Brendshëm”.

Aktiviteti

Në vitin 2010, Njësia e Auditit të Brendshëm në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ka realizuar planin vjetor të miratuar nga Bordi, i cili përcaktonte përfundimin e 10 auditimeve tematike. Funksioni i Auditit të Brendshëm, realizohet nga 1 specialist audit, me një përvojë 4 vjeçare pune në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Programi Kualifikues “Menaxhimi i Riskut në Tregun e Sigurimeve”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me FSVC-në, zhvilloi kursin e trajnimit me temë “Parimet e praktikave në tregun e sigurimeve dhe Bazat e Mbikëqyrjes me fokus riskun e këtij tregu”.

Kursi ishte pjesë përbërëse e një programi trajnimesh të organizuar në dy faza, përkatësisht në periudhat 31 maj - 11 qershor 2010 dhe 20 shtator - 8 tetor 2010 duke trajtuar konceptet bazë të menaxhimit të riskut dhe tregut të sigurimeve.

Kursi u drejtua nga Z. William Cundiff, ekspert me përvojë 40-vjeçare në fushën e sigurimeve, i cili mundësoi që prezantimet teorike të pasuroheshin me shembuj konkretë të praktikave të tregut të sigurimeve në Shtetet e Bashkuara dhe më gjerë.

Çdo pjesëmarrës në trajnim u pajis me një llogari dhe fjalëkalim për në adresën “Insurance University”, ku përmbledhej gjithë materiali i zhvilluar, i plotësuar me teste dhe fjalor teknik të termave të tregut të sigurimeve.



Gjatë vitit 2010 janë dhënë 17 rekomandime. Një procedurë auditi u realizua duke angazhuar mesatarisht 21.6 ditë pune. Në bazë të Rregullores së Brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Njësia e Auditit të Brendshëm, gjatë vitit 2010, ka raportuar periodikisht në Bord duke bërë transparente rezultatet e auditimeve të kryera.

Arkiv - Protokollit

Funksioni dhe aktiviteti

Zyra e Arkiv-Protokollit e kryen funksionin e saj në zbatim të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Korrespondenca zyrtare e Autoritetit, trajtohet në këtë zyrë nga një punonjës i vetëm. Për vitin 2010 janë përpunuar rreth 3375 praktika nga këto, 2250 praktika janë nxjerrë nga AMF në drejtim të palëve të interesit dhe pjesa tjetër i është drejtuar institucioneve të ndryshme, nga të cilat është kërkuar informacion nga ana e AMF-së. 1125 praktika janë përgjigjet e ardhura nga palët e interesit dhe institucionet e ndryshme shtetërore dhe private.


Edhe gjatë vitit 2010 është vërejtur fluks rritës në korrespondencë në periudhat e mbylljes së tremujorëve, periudha në të cilat shtohet komunikimi shkresor midis Autoritetit dhe subjekteve të mbikëqyrura të licencuara. Përveç komunikimit elektronik, brenda institucionit ka funksionuar edhe korrespondenca e brendshme. Kjo lloj korrespondence ka të bëjë me komunikimet brenda njësisë organizative, si pjesë përbërëse të strukturës së institucionit. Gjatë vitit 2010 rezultojnë 835 komunikime të tilla.

1.3 Buxheti dhe financimi

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare siguron të ardhura për funksionimin normal të aktivitetit të tij në mbështetje të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Financimi i aktivitetit të Autoritetit, për vitin 2010, u realizua tërësisht nga burimet e veta. Rreth 97% të të ardhurave u siguruan nga kontributet e shoqërive të sigurimit.

Hartimi i pasqyrave financiare të Autoritetit dhe mbajtja e kontabilitetit bëhet në zbatim të VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale e njësisë që varen prej tyre”, si dhe në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore”.

Nga viti 2007 e në vazhdim, pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit auditohen nga ekspertë kontabël të autorizuar, pavarësisht se një gjë e tillë nuk buron nga detyrime ligjore.



Raporti i audituesit të pavarur

Tabelë 1: Burimet e fondeve të AMF-së

<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera në Lekë</i>
1. Të ardhura nga veprimtaria	125,141,760
1.1 Të ardhura nga kontributet e shoqërive të sigurimit	121,303,022
1.2 Të ardhura nga subjektet që operojnë në tregun e letrave me vlerë	1,626,500
1.3 Të ardhura nga institutet e pensioneve private	507,057
1.4 Të ardhura nga licencime	1,269,450
1.5 Të ardhura nga gjoba, konvertime e interesa bankare	435,731
2. Financime të mbartura për investime në proces	29,200,000
TOTALI	154,341,760

Tabelë 2: Përdorimi i fondeve të AMF-së

<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera në Lekë</i>
1. Shpenzime funksionimi	88,996,732
1.1 Paga, shpërblime, sigurime shoqërore	52,594,665
1.2 Shpenzime operative	36,402,067
2. Investime	44,309,980
3. Investime në proces	6,990,498
4. Fonde të regjistruara për periudhat e ardhshme	14,044,550
TOTALI	154,341,760

Në totalin e shpenzimeve, shpenzimet e funksionimit, ku përfshihen shpenzimet për paga dhe shpërblime, si dhe shpenzimet operative, përfaqësojnë shpenzimet që zënë peshën më të madhe në buxhetin e AMF-së. Ato përfaqësojnë rreth 71% të të ardhurave të realizuara nga veprimtaria e vitit 2010.

Shpenzimet për investime janë orientuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike, me synim rritjen e rolit mbikëqyrës të Autoritetit në tregun financiar jo-bankar dhe në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës të stafit të AMF-së. Kështu, shpenzimet për investime konsistojnë në likuidimin e situacioneve për rikonstruksionin e godinës dhe në blerjen e pajisjeve kompjuterike. Këto shpenzime janë përballuar nga të ardhurat e realizuara nga veprimtaria gjatë vitit 2010, si dhe nga fonde të mbartura për investime në proces nga vitet e mëparshme.



Në zërin “Investime në proces” përfshihen disa punime të paparashikuara dhe rezultuara gjatë rikonstruksionit të ambienteve të reja. Këto punime kanë filluar në vitin 2010 dhe parashikohen të përfundojnë në 2011. Për këto investime do të përdoren fondet e vitit 2010.

Prokurimet

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si institucion i pavaruar, i krijuar me Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, për prokurimet me fondet publike të krijuara gjatë ushtrimit të funksioneve të ngarkuara me ligj, i nënshtrohet ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.1.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Autoriteti, gjatë vitit 2010, ka kryer gjithsej 7 procedura prokurimi, ndërsa për mbulimin e nevojave të tjera është operuar me prokurime me vlera të vogla. Vlen të theksohet realizimi me sukses i 6 procedurave të prokurimit, ndërkohë që është anuluar 1 procedurë për mungesë konkurrence. Kështu, është realizuar përmbyshja e objektivave sipas nevojave për mallra, shërbime duke i shërbyer me kërkesa gjithmonë e në rritje stafit dhe mirëfunksionimit të punës së Autoritetit.

Kapitulli 2 Aktiviteti i AMF

2.1 Aktiviteti rregullues

Gjatë vitit 2010, një ndër prioritetet kryesore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ka qenë draftimi dhe miratimi i legjislacionit rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare. Autoriteti, prej 3 vjetësh, po punon për futjen e mbikëqyrjes me bazë risku dhe drafti i ri i ligjit për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve, që pritet të finalizohet në 2011, së bashku me aktet nënligjore, do të mbështesin mbikëqyrjen e tregut me bazë riskun.

Në kuadër të përmirësimit të akteve ligjore ekzistuese dhe përafrimit të tyre me direktivat e BE-së, AMF hartoi 10 rregullore të reja dhe realizoi ndryshime në disa rregullore të tjera të mbikëqyrjes financiare jo-bankare.

Në vitin 2010, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, u hartua dhe u miratua:

Ligji nr. 10236, datë 18.02.2010 “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”

Ky ligj përcakton rregullat, që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike. Ligji zbatohet për ofertat publike, për blerjen e titujve të emetuar nga një shoqëri aksionare me seli brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në tregun e organizuar të titujve të Republikës së Shqipërisë, sipas Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”. Dispozitat e këtij ligji u kërkojnë ofruesve t’u drejtojnë aksionarëve të shoqërisë objekt i ofertës, një ofertë publike dhe transparente, dhe më pas, oferta monitorohet dhe mbikëqyret nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare.

Ligji është në përputhje me Direktivën 2004/25/EC, datë 21 prill 2004, “Për marrjen në kontroll të shoqërive”, e cila synon të arrijë një qartësi dhe transparencë në mbarë BE-në, për çështjet që duhen zgjidhur në rast të ofertave për marrjen në kontroll të shoqërive publike dhe të parandalohet situata, në të cilën skemat e riorganizimit të shoqërive tregtare brenda BE-së të shtrembërohen nga diferencat arbitrare në kulturat e drejtimit të brendshëm të shoqërive dhe të administrimit të tyre.

Ky ligj ka si synim krijimin e kushteve lehtësuese në kryerjen e transaksioneve tregtare, si dhe ndërmarrjen e reformave, me qëllim përmirësimin e klimës dhe kushteve operuese të biznesit, duke krijuar kështu bazat për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe thithjen e investimeve të huaja.

Aktet nënligjore në fushën e titujve

Arritjet legjislative për 2010 në fushën e titujve u konkretizuan me miratimin e rregullave të reja për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e tregut të obligacioneve, në zbatim të Ligjit nr. 10 158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”.



Gjithashtu në drejtim të rishikimit të bazës rregullatore, forcimit të mbikëqyrjes, zhvillimit të mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjes së investitorit, Autoriteti pasqyroi ndryshime me rëndësi në disa akte nënligjore në fuqi të fushës së titujve.

Rregullore nr. 124, datë 7.12.2010 “Mbi afatet, kushtet dhe procedurat për autorizim të bankave si kujdestarë të obligacioneve” e cila përcakton: a) afatet kohore, kushtet dhe procedurat për autorizimin e kujdestarëve të obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore, b) informacionin që duhet të jepet nga bankat që veprojnë si kujdestarë të obligacioneve dhe që veprojnë si nxitës tregu për klientët e tyre, në lidhje me këto obligacione dhe me transaksionet në vazhdim dhe c) masat shitesë që ndërmerren nga Autoriteti në rast shkeljeje të detyrimeve të parashikuara me ligj.

Gjithashtu, janë bërë edhe ndryshime në rregulloret ekzistuese:

Rregullore nr. 21, datë 26.03.2009 “Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë” dhe Rregullore nr. 22, datë 26.03.2009 “Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë” - Miratuar me Vendim Bordi nr. 69, datë 28.06.2010.

Rregullore nr. 21, datë 26.03.2009 “Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë” dhe Rregullore nr. 22, datë 26.03.2009 “Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë” - Miratuar me Vendim Bordi nr. 29, datë 19.03.2010.

Rregullore nr. 120, datë 02.10.2008 “Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve” - Miratuar me Vendim Bordi nr. 23, datë 19.03.2010.

Aktet nënligjore në fushën e pensioneve

Një aspekt i rëndësishëm në punën e AMF-së gjatë vitit 2010 ka qenë zhvillimi i tregut të pensioneve vullnetare, sidomos pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”. Në këtë drejtim Autoriteti ka bërë një punë të madhe, veçanërisht nëpërmjet forcimit të bazës rregullative, me hartimin dhe miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit për pensionet vullnetare.

Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”

Synon:

- administrimin me efektivitet të fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet diversifikimit të investimeve,

me synim rritjen e kontributeve të bëra në fondin e pensionit;

- mbikëqyrjen e biznesit të fondit të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit;
- nxitjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aseteve të fondit të pensionit;
- licencimin dhe mbikëqyrjen e shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe planit të pensionit profesional, të depozitarit të aseteve të fondeve të pensionit dhe të të gjitha çështjeve të lidhura me to.

Përafuar me:

- Direktivën 85/611/EEC “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me shoqëritë e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm”;
- Direktivën 2003/41/EC “Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjes e institucioneve të pensioneve profesionale”;
- Direktivën 2004/39/EC “Mbi tregjet e instrumentave financiarë”.

Skema e re e organizimit dhe funksionimit të pensioneve vullnetare, e sanksionuar në ligjin e ri, përbën një risi për tregun financiar shqiptar. Një aspekt i rëndësishëm i këtij ligji është përfshirja e lehtësirave tatimore të kontributeve të anëtarëve të fondit të pensionit. Për të siguruar zbatueshmërinë e kësaj kërkesë ligjore, e cila e bën skemën e pensionit vullnetar më atraktive për kontribuesit dhe punëdhënësit, Autoriteti, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, dha kontribut në përfshirjen e lehtësive tatimore të pensioneve vullnetare në Ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Sipas Ligjit nr. 10343, kontributet e bëra nga punëdhënësi për pensionet vullnetare njihen si shpenzim i zbritshëm. Po kështu, kontributi i bërë nga çdo individ për skemën e pensionit vullnetar njihet si shpenzim i zbritshëm për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme të tatimpaguesit që plotëson deklaratën vjetore të të ardhurave.

Në kuadrin e lehtësive tatimore për nxitjen e tregut financiar jo-bankar, vlen të përmendet edhe njohja e shpenzimeve të sigurimit të jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve nga punëdhënësi, si shpenzime të zbritshme, në Ligjin nr. 10 364, datë 16.12.2010 “ Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Rregulloret e miratuara gjatë 2010, në fushën e pensioneve vullnetare, janë si më poshtë:

Rregullore nr. 126, datë 07.12.2010 “Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar”, e cila përcakton mënyrat kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit në llogarinë e anëtarit të fondit të pensioneve vullnetare, pasi ka fituar të drejtën e tërheqjes dhe përdorimit të tyre në bazë të dispozitave ligjore.

Rregullore nr. 125, datë 07.12.2010 “Për penaltitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit vullnetar”, e cila përcakton kufirin dhe mënyrën e zbatimit të penaltetit në rast të tërheqjes së parakohshme nga anëtari të aseteve, nga llogaria individuale në fondin e pensionit vullnetar.



Rregullore nr. 113, datë 18.11.2010 “Për testimin e administratorëve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve”, e cila bën përcaktimin e procedurave të organizimit të testimit të administratorëve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve, ngritjen e komisionit të testimit, si dhe rastet e delegimit të organizimit të testimit në qendra të specializuara ose universitete/fakultete.

Rregullore nr. 18/1, datë 25.02.2010 “Për tarifat e licencimit dhe funksionimit të shoqërisë administruese, depozitarit dhe agjentit të fondeve të pensionit vullnetar”, e cila përcakton elementët dhe madhësinë e tarifave për licencimin, miratimin, autorizimin, funksionimin e shoqërisë administruese, depozitarit dhe agjentit të fondeve të pensionit vullnetar dhe penalitetet për pagesat e vonuara.

Rregullore nr. 1, datë 28.01.2010 “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit”, e cila përcakton aktivet e lejuara, që mund të investohet fondi i pensionit, kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit.

Gjithashtu, janë bërë edhe ndryshime në rregulloren ekzistuese:

Rregullore nr. 1, datë 28.01.2010 “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit” - miratuar me Vendim Bordi nr. 109, datë 18.10.2010.

Aktet nënligjore në fushën e sigurimeve

Për vitin 2010, zhvillimet legjislative në fushën e sigurimeve u fokusuan më së shumti në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të Ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Përmirësimi i kuadrit ligjor në këtë fushë ka për qëllim forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes, nga ana e Autoritetit, të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik, si produktet që zënë peshën më të madhe në tregun e sigurimeve në vend.

Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”

Synon:

- përmirësimin e procedurave të trajtimit të dëmeve duke përfshirë dhe trajtuar për herë të parë konceptin e dëmit jopasuror ose të ashtuquajtur “dëm moral”, që vjen si pasojë e dëmtimeve të integritetit fizik dhe psikologjik, të pësuar nga palët në një aksident dhe në aspekte të tjera të trajtimit të dëmeve;
- krijimin e detyrimeve për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të aksidenteve, duke hedhur bazat për krijimin e një sistemi bonus malus në të ardhmen, nëpërmjet krijimit të Qendrës së Informacionit në Sigurime;

- zgjerimin e gamës së produkteve të sigurimit të detyrueshëm me dy produkte të reja: (1) sigurimin e detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, si dhe (2) sigurimin e përgjegjësishë për dëmin e shkaktuar palës së tretë nga përdorimi i mjeteve të transportit ajror dhe mjeteve lundruese.

Përafruar me:

- Direktivën 72/166/EEC mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me sigurimin e përgjegjësishë gjatë përdorimit të mjeteve motorike dhe detyrimi për t'u siguruar kundrejt kësaj përgjegjësishë;
- Direktivën 84/5/EEC mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me sigurimin e përgjegjësishë gjatë përdorimit të mjeteve motorike;
- Direktivën 88/357/EEC mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve, dispozitave administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, duke përjashtuar sigurimin e jetës dhe përcaktimin e dispozitave që lehtësojnë ushtrimin sa më efikas të së drejtës për të ofruar shërbime duke amenduar Direktivën 73/239/EEC;
- Direktivën 90/232/EEC mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me sigurimin e përgjegjësishë gjatë përdorimit të mjeteve motorike;
- Direktivën 2000/26/EC mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me sigurimin e përgjegjësishë gjatë përdorimit të mjeteve motorike duke amenduar Direktivat 73/239/EEC dhe 88/357/EEC;
- Direktivën 2005/14/EC mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me sigurimin e përgjegjësishë gjatë përdorimit të mjeteve motorike duke amenduar Direktivat 72/166/EEC, 84/5/EEC, 88/357/EEC, 90/232/EEC dhe 2000/26/EC;
- Rregulloren e Këshillit Evropian (EEC) Nr. 2407/92 mbi licencimin e mjeteve transportuese ajrore.

Rregullore nr. 22, datë 19.03.2010 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, e cila përcakton rregulla në lidhje me krijimin, llogaritjen, financimin dhe administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve, duke përfshirë edhe rregulla në lidhje me kontributet e çdo shoqërie sigurimi.

Rregullore nr. 21, datë 19.03.2010 “Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të kartonit jeshil”, e cila përcakton rregullat mbi administrimin e fondit të garancisë së Kartonit Jeshil për të garantuar detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil dhe kriteret bazë të pajisjes së anëtarëve me Certifikatë Ndërkombëtare Sigurimi.

Rregullore nr. 20, datë 19.03.2010 “Mbi masën e kontributit vjetor të shoqërive të sigurimit”, e cila përcakton masën e kontributit vjetor që i paguhet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, nga shoqëritë e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, gjatë ushtrimit të aktivitetit sigurues.



Rregullore nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, e cila përcakton rregullat dhe standardet e mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, përmbajtjen dhe afatet e raportimit të saj pranë Autoritetit. Kjo rregullore synon:

- garantimin e detyrimeve financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil;
- zbatimin e detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit;
- garantimin e pagesave të dëmeve nga Fondi i Kompensimit;
- zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në Këshillin e Byrove;
- zbatimin e detyrimeve të tjera ligjore që lidhet me veprimtarinë e Byrosë.

Gjithashtu, janë bërë edhe ndryshime në aktet nënligjore ekzistuese:

Rregullore nr. 10, datë 17.12.2007 “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit”
- miratuar me Vendim Bordi nr. 81, datë 30.08.2010.

Udhëzim nr. 10, datë 08.02.2007, “Për listën e dokumentave të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit” - miratuar me Vendim Bordi nr. 78, datë 15.07.2010.



Bordi drejtues i AMF-së

Të tjera

Ndryshim në Rregulloren nr. 7, datë 30.08.07 “Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” - miratuar me Vendim Bordi nr. 123, datë 18.11.2010 dhe Vendim Bordi nr. 18, datë 25.02.2010.

Objektivat

Autoriteti, edhe gjatë vitit 2011, do të vazhdojë të thellojë përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e bazës rregullative të nevojshme për një zhvillim sa më normal dhe të qëndrueshëm të tregjeve financiare jo-bankare. Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor për një mbikëqyrje sa më efektive të tregut financiar jo-bankar dhe adaptimi i proceseve rregullatore dhe mbikëqyrëse të qarta, transparente dhe të qëndrueshme, do të mbeten objektivat kryesore të AMF-së edhe për 2011.

Në kuadër të projektit për një mbikëqyrje efektive, financuar nga FIRST Initiative, Autoriteti pritet që në 2011, në bashkëpunim me Bankën Botërore, të përfundojë procesin e hartimit të

ligjit të ri për sigurimin dhe risigurimin. Ky draftligj po përafrohet me direktivat evropiane përkatëse, duke marrë në konsideratë praktikatat më të mira të vendeve të rajonit dhe duke u fokusuar në kërkesat dhe zhvillimet më të fundit të tregut të sigurimeve në vend.

Ndërkohë që gjatë po këtij viti, me qëllim forcimin e elementeve të pavarësisë dhe forcimit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të Autoritetit, do të hartohen edhe ndryshime të reja në ligjin “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Për zbatimin sa më efikas të ligjeve të reja “Mbi fondet e pensionit vullnetar” dhe “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tregut të pensioneve dhe letrave me vlerë, AMF do të vazhdojë të ketë si prioritet edhe gjatë 2011 hartimin dhe ndjekjen e procesit të miratimit të një sërë rregulloresh që do të dalin në zbatim të këtyre ligjeve:

- rregullore, që përcakton asetet dhe detyrimet e sipërmarrjeve kolektive të investimit, si dhe bazën, mënyrën dhe kufijtë kohorë për llogaritjen e vlerës neto të aseteve dhe të vlerës neto të aseteve për kuotë ose aksion;
- rregullore, ku përcaktohen përmbajtja e raportimeve dhe kufiri kohor, brenda të cilit duhet t’u paraqiten raportimet nga sipërmarrjet e investimeve kolektive, shoqërië administruese dhe depozitarëve;
- rregullore për të përshkruar metodën e zbatimit të detyrave të depozitarit;
- rregullore për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të investitorëve nga ana e depozitarit;
- rregullore për procedurën, kostot dhe kufijtë kohorë për prishjen e fondeve të investimit;
- rregullore për bazën e detyrueshme të llogaritjes për sipërmarrjet e investimeve kolektive, në lidhje me përcaktimin e vlerës së aseteve, duke përfshirë edhe titujt;
- rregullore për rrethanat e veçanta kur pagesat në fondet e investimit përveç aseteve monetare mund të bëhen edhe në tituj apo asete të tjera;
- rregullore për bazën, përbërësit, mënyrën dhe kufijtë kohorë të llogaritjes, për përcaktimin e vlerës dhe të çmimit të fondeve të investimit, përbërësit, kufizimet, mënyrën e llogaritjes, mbledhjen dhe publikimin e tarifave për kuotat në fondin e investimeve;
- rregullore për blerjen e aseteve nga shoqëria administruese për fondin e investimit vetëm në emër dhe për llogari të fondit të investimit, domethënë të mbajtësve të kuotave të fondit që ajo administron dhe në emër dhe për llogari të shoqërisë së investimit, duke i depozituar asetet te një depozitar;
- rregullore për të përcaktuar vlerën e transaksioneve të kontratave të së ardhmes dhe e mundësisë të derivativeve, për të cilat nuk është e mundur të përcaktohet çmimi i tregut, duke përcaktuar mënyrat e përlllogaritjes së vlerës së këtyre aseteve.



2.2 Aktiviteti licencues

Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta në procesin licencues, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e licencimit të zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrorjnë aktivitetet në tregun financiar jo-bankar, të jenë të qarta, objektive dhe transparente, duke e vënë theksin:

- në gjendjen e shëndoshë financiare të aplikantit;
- në aftësitë profesionale dhe të besueshmërisë të stafit drejtues dhe vendimmarrës të aplikantit;
- në hartimin e strukturave të kënaqshme të mënyrës së qeverisjes së aplikantit;
- në paraqitjen e planeve financiare dhe të biznesit në mënyrë sa më të qartë dhe të argumentuar.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në ushtrimin e funksionit licencues, krahas funksionit mbikëqyrës, ka synuar dhe synon drejt një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar, si dhe rritjes së mëtejshme të besimit të publikut ndaj këtij tregu. Licencimi i subjekteve që kërkojnë të ushtrorjnë veprimtari në tregun financiar jo-bankar, edhe gjatë vitit 2010 ka qenë pjesë e objektit të veprimtarisë së Autoritetit.

Risia e këtij viti, në aspektin licencues, ka qenë licencimi i shoqërisë së parë administruese të fondeve të pensionit vullnetar. Miratimi i Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, diktoi nevojën e aplikimit për licencë të instituteve ekzistuese private të pensioneve, në përshatje me kërkesat e ligjit të ri.

LICENCAT QË LESHON AUTORITETI

- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri sigurimi
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri risigurimi
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si degë e shoqërisë së huaj të sigurimit
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si agjent në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri agjentësh në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si broker në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri brokerimi në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime
- Autorizim për ushtrimin e veprimtarisë si Aktuar i Autorizuar
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si konsulent në sigurime
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri administruese
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si depozitar
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si agjent i fondit të pensionit
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri agjentësh të fondit të pensionit
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si degë e shoqërisë administruese
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri investimi kolektive me ofertë publike
- Licencë për ushtrim veprimtarie si shoqëri brokerimi në tituj
- Licencë për ushtrim veprimtarie si broker në tituj / komisioner burse
- Licencë për ushtrim veprimtarie si këshilltar investimesh
- Autorizim për ushtrimin e veprimtarisë si kujdestar i autorizuar
- Licencë për ushtrim veprimtarie si bursë titujsh
- Licencë për ushtrim veprimtarie si regjistrar

Aktiviteti licencues në tregun e pensioneve vullnetare

“Shoqëri administruese e fondit të pensionit vullnetar”, është një shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe e licencuar nga Autoriteti, për të administruar një ose disa fonde të pensionit.

Funksionet kryesore të shoqërisë administruese janë mbledhja dhe investimi i fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut (diversifikim), për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit. Shoqëria administruese, gjithashtu, mund të ketë edhe funksionin e kryerjes së pagesave të pensionit.

Organizimi dhe funksionimi i pensioneve vullnetare, sipas ligjit të ri, përfaqëson një skemë të re në administrimin e pensioneve vullnetare. Veçanërisht në këtë skemë organizimi, një rëndësi e madhe i kushtohet profesionalizmit të stafit drejtues të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit vullnetar, duke gjykuar për veçoritë që paraqet administrimi i fondeve të pensioneve vullnetare.

Instituti Privat i Pensioneve Raiffeisen

është shoqëria e parë që aplikoi për licencë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Bordi i AMF-së, në mbledhjen e datës 18.10.2010, miratoi dhënien e licencës **“Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen” sh.a** për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Autoriteti, në gjykim të kërkesës për përshtatshmëri dhe aftësi profesionale të administratorëve, vlerësoi eksperiencën dhe karrierën profesionale të stafit të përzgjedhur nga Shoqëria administruese e fondeve të pensionit Raiffeisen.



Gjatë ceremonisë për dhënien e licencës “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen” sh.a

Gjithashtu, në mbledhjen e muajit tetor, Autoriteti miratoi prospektin dhe kontratën e “Fondit të pensionit vullnetar Raiffeisen”, që shënoi njëkohësisht miratimin e këtij fondi nën administrimin e **“Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen” sh.a**.

Kryerja e veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit vullnetar lidhet domosdoshmërisht me ekzistencën e depozitarit të licencuar nga Autoriteti.

Shoqëria “First Investment Bank - Albania”

sh.a (Fibank) ishte shoqëria e parë që aplikoi për licencë për të vepruar si depozitar i fondeve të pensionit vullnetar. Në muajin gusht 2010, Autoriteti licencoi Shoqërinë “First Investment Bank - Albania” sh.a për të vepruar si depozitar, pasi vlerësoi përbushjen e kërkesave ligjore, veçanërisht duke gjykuar mbi përshtatshmërinë e sistemit për



regjistrimin e aseteve të fondit të pensioneve.

Shoqëria “First Investment Bank - Albania” sh.a ka lidhur kontratë për shërbime depozitari me “Shoqërinë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen” sh.a.

Në muajin nëntor u licencua edhe shoqëria **“Tirana Bank” sh.a** për të vepruar si Depozitar i fondit të pensionit vullnetar. Kjo shoqëri ka instaluar sistemin “AIS – CUSTODY”, i cili mbulon tërësinë e plotë të operacioneve të shërbimit të kujdestarisë dhe depozitimit.

“Depozitar” është banka e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit, si dhe e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit.

Depozitarit kryen këto funksione:

- llogarit vlerën neto të aseteve të fondit të pensionit;
- kontrollon se si administron asetet e fondit të pensionit, shoqëria administruese;
- siguron që t'i kthehet fondit të pensioneve çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara;
- siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit të shpërndahen në përputhje me kontratën e fondit të pensionit dhe me legjislacionin në fuqi.

Aktiviteti licencues në sigurime

Gjatë vitit 2010, aktiviteti licencues i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në fushën e sigurimeve, u fokusua në këto drejtime:

- licencime të subjekteve që operojnë në tregun e sigurimeve si ndërmjetës: broker dhe agjentë, si dhe vlerësues të dëmeve në sigurime;
- miratime të pjesëmarrjes influencuese të kapitalit të huaj, si dhe ndryshime statutore të shoqërive të sigurimit, që lidhen me ndryshimin e kapitalit, strukturës aksionare, apo neneve të ndryshme të statutit, si dhe;
- miratime të organeve drejtuese të shoqërive të sigurimit.

Broker në sigurime

Veprimtaria e brokerimit në sigurime, si veprimtari që filloi për herë të parë në tregun shqiptar të sigurimeve në 2008, vijoi të paraqesë interes edhe për subjekte të tjera. Gjatë vitit 2010, u licencuan 4 shoqëri të tjera brokerimi në sigurime, shoqëruar me licencimin e brokerave fizikë, duke e çuar në 8 numrin e shoqërive të brokerimit që operojnë në tregun shqiptar të sigurimeve, si dhe në 10 numrin e brokerave fizikë që ushtrojnë veprimtari në emër dhe për llogari të këtyre shoqërive.

Shoqëritë e brokerimit të licencuara gjatë vitit 2010 janë:

Shoqëria **“All-SIG”** sh.a, si broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës;

Shoqëria **“Broker GABA”** sh.a, si broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës;

Shoqëria **“A-Eja Insurance Broker”** sh.a, si broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës, si dhe;

Shoqëria **“First Broker”** sh.a, si broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës.

Agjentë në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka kërkuar vazhdimisht nga shoqëritë e sigurimit që shitja e policave të sigurimit në emër të tyre të bëhet nga agjentë të licencuar. Gjatë vitit 2010, u licencuan nga AMF 10 agjentë, persona fizikë, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit : “Insig” sh.a, nga të cilët vetëm 2 të licencuar për herë të parë, ndërsa 8 agjentë rinovuan licencën e agjentit të marrë 3-vjet më parë.

Tabelë 3: Të dhëna mbi agjentë të licencuar

<i>Emërtimi</i>	<i>Persona Juridike</i>	<i>Persona Fizike</i>
Agjentë të licencuar deri në vitin 2009	8	161
Agjentë të rilicencuar në vitin 2010	-	8
Agjentë të rinj të licencuar në vitin 2010	-	2
Tërheqje apo refuzim licence 2010	-	1
GJITHSEJ TË LICENCUAR	8	162

Gjatë kësaj periudhe, Autoriteti tërhoqi 1(një) licencë për agjentë në sigurime në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Insig” sh.a, me kërkesë të të licencuarit.

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Vlerësimi i dëmeve nga shoqëritë e sigurimit me vlerësues të licencuar, si proces i filluar në vitin 2008 u shoqërua dhe gjatë vitit 2010 me licencimin e 11 vlerësuesve të tjerë, duke e çuar në 54 numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime.

Për herë të parë, gjatë vitit 2010, u licencua shoqëria e parë e vlerësuesve të dëmeve “Havus Albania” sh.a, e cila konsiston në vlerësimin e dëmeve materiale dhe shëndetësore.

Tabela më poshtë pasqyron të dhënat mbi vlerësuesit e licencuar të ndarë sipas llojit të licencës dhe sipas statusit të tyre.

Tabelë 4: Të dhëna mbi vlerësuesit e licencuar që operojnë në tregun e sigurimeve, në vite

<i>Viti</i>	<i>Statusi i vlerësuesit</i>		<i>Lloji i licencës</i>			<i>Gjithsej vlerësues të licencuar</i>
	<i>i pavarur</i>	<i>i punësuar</i>	<i>për dëme materiale</i>	<i>për dëme shëndetësore</i>	<i>për dëme materiale dhe shëndetësore</i>	
2008	11	21	1	6	25	32
2009	16	27	1	7	35	43
2010	20	34	3	7	44	54



Testi profesional për profesionet në fushën e sigurimeve

Aktet nënligjore mbi përcaktimin e kriterëve të licencimit të profesioneve në fushën e sigurimeve, si profesioni i brokerit në sigurime, profesioni i vlerësuesit të dëmeve, apo profesioni i aktuarit, kanë përcaktuar si kusht licencimi edhe kalimin me sukses të testimit për njohuritë në fushën përkatëse.

Gjatë vitit 2010, Autoriteti ka organizuar rregullisht testime në përputhje me kërkesat e paraqitura nga aplikantët të ndryshëm për t'u pajisur me licenca përkatëse. Qëllimi i organizimit të testeve ka qenë vënia e theksit tek profesionalizmi i aplikantëve që kërkojnë të licencohen, me synim kryerjen e shërbimeve financiare nga profesionistë që njohin legjislacionin dhe fushën e aktivitetit ku do të operojnë. Në përbërje të komisioneve të testimit është synuar të jenë përfaqësues me reputacion dhe eksperiencë, si nga rrethi akademik, ashtu edhe nga tregu.

Prezenca e kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimit


Gjatë vitit 2010, në tregun shqiptar të sigurimeve u shfaq interesi për blerjen e aksioneve nga shoqëri të huaja financiare. Për sa më sipër, në nëntor të 2010, Autoriteti miratoi pjesëmarrjen influencuese të aksionarit “Wiener Staditsche Versicherung AG Vienna Insurance Group” në masën 75% + 1 aksion në shoqërinë e sigurimit “Interalbanian” sh.a. Aktualisht, “Vienna Insurance Group” ka kontroll në masën 87% + 1 edhe tek shoqëria e sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a. Gjithashtu, shoqëria slovene e sigurimeve “Zavarovalnica Triglav” d.d në bazë të marrëveshjes me shoqërinë e sigurimit “Albsig” sh.a bleu 9.9% të kapitalit aksionar të kësaj shoqërie.

Për sa më sipër, për vitin 2010, numri i aksionarëve të huaj që zotërojnë aksione në shoqëritë shqiptare të sigurimit u rrit dhe aktualisht në tregun shqiptar të sigurimeve operojnë: “Wiener Staditsche Versicherung AG Vienna Insurance Group” me seli kryesore në Vienë, Austri, “Uniqa International Beteiligungs -Verwaltungs GmbH” me seli kryesore në Vienë, Austri dhe “Zavarovalnica Triglav” d.d me seli në Lubjanë, Sloveni, si dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve.

Qeverisja e shoqërive të sigurimit

Edhe për vitin 2010, struktura e qeverisjes së shoqërive të sigurimit nuk pati ndryshime, ajo paraqitet si skema në krah.


Struktura aktuale



Në rritjen e rolit mbi qeverisjen e shoqërive të sigurimit, AMF ka respektuar kriteret për të zgjedhurit në këshillat mbikëqyrës, në postet drejtuese apo komitetet e kontrollit. Në të njëjtën kohë, AMF ka tentuar të nxisë rritjen e integritetit, profesionalizmit, eksperiencës dhe kualifikimit, brenda kuadrit ekzistues rregullativ. Gjatë vitit 2010, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës në pesë shoqëri sigurimi, si dhe ka miratuar riemërimin e drejtorit të përgjithshëm në pesë shoqëri sigurimi.

Qeverisja e shoqërive të sigurimit - statistika	2007	2008	2009	2010
Numri mesatar i aksionarëve	6.0	4.5	4.2	4.4
Numri mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës	5.0	3.6	3.4	3.6
Numri mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionarë	2.0	2.8	2.7	3.1
Numri i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese mbi 10%	3.0	3.0	2.0	2.0

Numri i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese




Tabelë 5: Të dhëna për aksionarët - 2010


Emërtimi	Numri
Shoqëri sigurimi	10
Aksionarë gjithsej	44
Me pjesëmarrje zotëruese si më poshtë:	
nën 10%	28
mbi 10% nën 20%	4
mbi 20% nën 33 %	2
mbi 33% nën 50%	1
mbi 50%	9
Aksionarë të huaj	4
Aksionarë vendas	40
Aksionarë si individë	36
Aksionarë si shoqëri	7
Aksionarë shteti	1



Të dhëna për aksionarët - 2010



Struktura e kapitalit sipas vendit të origjinës - 2010



Miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit

Miratimet e dhëna nga Autoriteti gjatë vitit 2010 në lidhje me ndryshimet statutore kanë konsistuar:

- në ndryshimin e statutit si rezultat i ndryshimit të madhësisë së kapitalit aksionar për 2 shoqëri sigurimi;
- në ndryshimin e statutit si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare për 5 shoqëri sigurimi;
- statut i ri apo ndryshim të neneve të statutit për 3 shoqëri sigurimi.

Emërtimi	Numri i Shoqërive		
	2008	2009	2010
Statut i ri	2	2	3
Rritje kapitali	9	4	2
Ndryshim i strukturës aksionare	2	2	5

Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt" dhe Rregullores nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë", 5 shoqëri të licencuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji për të vepruar si regjistruar të letrave me vlerë të qeverisë, gjatë vitit 2010, aplikuan dhe u pajisën me autorizimin për të vepruar si kujdestarë të letrave me vlerë të Qeverisë së R.Sh. Operacionet e lidhura me kujdestarinë e letrave me vlerë kryhen nga bankat, të cilat paraprakisht kanë marrë miratimin nga Banka e Shqipërisë për këtë veprimtari.

Përveç sa më sipër, gjatë vitit 2010, Autoriteti autorizoi edhe 2 banka të tjera për të vepruar si kujdestarë të letrave me vlerë të Qeverisë.

Gjatë vitit 2010, Autoriteti miratoi dhënien e licencës për 2 banka për të ushtruar veprimtari tregtimi, si shoqëri brokerimi (broker-dealer) në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në Bursë dhe në tregun me pakicë, si dhe 3 brokera fizikë për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërive të licencuara.

Bankat e licencuara nga Autoriteti për të operuar në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë dhe të autorizuara për veprimtarinë e kujdestarit janë: "Raiffeisen Bank" sh.a, "Intesa SanPaolo Bank" sh.a, "Banka Kombëtare Tregtare" sh.a, "Alfa Bank Albania" sh.a, "Banka Credins" sh.a, "Tirana Bank" sh.a dhe "First Investment Bank" sh.a.

Subjekte të licencuara	2006	2007	2008	2009	2010
Shoqëri komisionere të letrave me vlerë	9	11	12	11	12
Broker fizik në shoqëri komisionere	12	14	15	14	16
Kujdestarë të letrave me vlerë të Qeverisë së R.Sh	0	0	0	0	7
Rregjistruar të letrave me vlerë	6	6	6	6	1
Tregje të organizuar të letrave me vlerë	1	1	1	1	1

Shënim: Ndryshimi nga vitit 2009 në vitin 2010 në subjektet që operojnë si kujdestarë të letrave me vlerë të Qeverisë së R.Sh dhe subjekteve që operojnë si Regjistruar të letrave me vlerë, ndodh për faktin e ndryshimit të kushteve që duhet të plotësojnë këto subjekte në bazë të Ligjit të nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt".

2.3 Aktiviteti mbikëqyrës

Gjatë vitit 2010, Autoriteti në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, ka analizuar dhe monitoruar veprimtarinë e këtij tregu, me prioritet përmirësimin e procesit të mbikëqyrjes së tij dhe mbrojtjen e interesave të të siguruarve.



Ruajtja e Stabilitetit Financiar - Asistencë teknike nga FIRST/IBRD

Programi i asistencës teknike “Ruajtja e Stabilitetit Financiar”, u financua nga First Initiative nëpërmjet IBRD, në kuadër të ruajtjes së stabilitetit financiar në kushtet e një krize financiare të mundshme. Ky program filloi në vitin 2009, me qëllim që të ndihmonte autoritetet pjesëmarrëse të shqyrtonin, vlerësonin dhe forconin procedurat përkatëse ekzistuese të reagimit dhe bashkëpunimit në kushtet e një krize potenciale që mund të ketë ndikim negativ të konsiderueshëm në sistemin financiar dhe ekonomi. Puna për realizimin e këtij programi vijoi edhe gjatë vitit 2010.

Në këtë program të asistencës teknike morën pjesë: Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Ky program u zhvillua me dy faza. Gjatë fazës së parë u shqyrtuan të gjitha procedurat ekzistuese, me fokus të veçantë bashkëveprimin ndër institucional, përfshirë këtu draftimin e një plan veprimi në raste krizash të mundshme financiare. Në vijim të kësaj faze, Banka e Shqipërisë përgatiti një draft Memorandum Bashkëveprimi, i cili vendosi përgjegjësitë e secilit nga institucionet e lart përmendura, si dhe sugjeroi një mënyrë të mundshme veprimi për të siguruar reagim të koordinuar dhe efektiv të tyre.

Faza e dytë e këtij programi iu kushtua testimit të procedurave ekzistuese dhe rekomandimeve për përmirësimin e tyre. Kështu në shtator 2010 u krye një ushtrim simulimi i një krize. Ky ushtrim siguroi jo vetëm testimin e procedurave ekzistuese të reagimit dhe bashkëveprimit në rast krize të mundshme por krijoi mundësinë për t'u familiarizuar dhe shqyrtuar draftin e memorandumit përpara se ky i fundit të nënshkruhej.

Analiza Financiare e Tregut të Sigurimeve (off-site)

Në lidhje me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, Autoriteti gjatë vitit 2010, mbështetur në kuadrin ligjor dhe me prioritet ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes, ka analizuar dhe monitoruar veprimtarinë e këtij tregu. Vlen të theksohet, se për pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së këtij tregu është bërë një analizë më e detajuar financiare.

Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve përfshin raportimin e saktë dhe në kohë të pasqyrave financiare dhe teknike, analizën e informacionit të marrë mbi aktivitetin e shoqërisë së sigurimit nëpërmjet raportimit, si dhe inspektimin në vend.

Në lidhje me raportimin e pasqyrave financiare dhe teknike, Autoriteti shqyrton saktësinë dhe depozitim në kohë të informacionit, mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi. Shoqëritë e sigurimit përgatisin pasqyrat financiare mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të

Raportimit Financiar (SNRF) dhe rregulloreve që Autoriteti ka nxjerrë për këtë qëllim. Nëse gjatë raportimit ndodh ndonjë shkelje ose parregullsi, Autoriteti kërkon nga shoqëria e sigurimit eliminimin e tyre ose ndërmerr masa të tjera të përshtatshme mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi.

Më pas, në Autoritet kryhet analiza financiare e veprimtarisë së shoqërive të sigurimit mbi bazën e informacionit të depozituar me anë të pasqyrave teknike e financiare, të depozituara nga subjektet e mbikëqyrura, si dhe çdo informacion tjetër kërkuar për këtë qëllim. Nëse nga analiza financiare e veprimtarisë së shoqërive të sigurimit vihet re parregullsi apo mangësi, Autoriteti reagon përkatësisht për eliminimin e shkeljeve.

Analiza e thelluar financiare bëhet përmes vlerësimit të pozicionit financiar, rezultateve teknike dhe financiare të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit mbështetur në të dhënat e raportimit vjetor dhe tremujor të këtyre shoqërive në Autoritet.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe provigjoneve teknike. Autoriteti vlerëson, nëse provigjonet teknike, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj të siguruarve janë të mjaftueshme dhe mbulohen jo më pak se vlera bruto e tyre me aktive të përshtatshme në çdo kohë. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të kenë mjaftueshmëri kapitali në çdo kohë. Mos përmbushja e kërkesave për minimumin e kapitalit të kërkuar, përbën shkelje të rregullave të manaxhimit të riskut. Nëse Autoriteti vë re ndonjë parregullsi në përmbushjen e këtyre treguesve, ndërmerr masat e duhura.

Struktura e tregut të sigurimeve, edhe gjatë vitit 2010, vazhdon të përbëhet nga dhjetë shoqëri sigurimi, nga të cilat gjashtë shoqëri ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës, dy shoqëri në sigurimet e Jetës, një shoqëri kompozite e Jetës dhe Jo-Jetës dhe një shoqëri e Jo-Jetës dhe shoqëri Risigurimi.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Aktualisht shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në “depozita qëllimore” me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari, sipas kërkesave të ligjit.



Tabelë 6: Struktura dhe dinamika e Aktivit dhe Pasivit të tregut të sigurimeve

Emërtimi	31.12.2008	31.12.2009	31.12.2010
	<i>struktura (në %)</i>		
Depozita	48.96	49.86	50.84
Toka dhe ndërtime	10.43	9.76	10.23
Aksione dhe pjesëmarrje	8.62	8.26	9.31
Bono thesari	4.02	3.01	4.91
Debitorë	7.52	8.41	8.45
Aktive të tjera	20.45	20.69	16.26
Totali i Aktivit	100.00	100.00	100.00
Provigjonet teknike bruto	33.10	38.39	34.21
Detyrime të tjera	10.01	8.95	8.06
Kapitalet e veta	56.89	52.66	57.73
Totali i Pasivit	100.00	100.00	100.00
Emërtimi	31.12.2008	31.12.2009	31.12.2010
	<i>dinamika (në %) viti i mëparshëm = 100</i>		
Depozita	-	106.46	113.35
Toka dhe ndërtime	-	97.80	116.45
Aksione dhe pjesëmarrje	-	100.09	125.36
Bono thesari	-	78.34	181.14
Debitorë	-	116.87	111.32
Aktive të tjera	-	105.76	87.38
Totali i Aktivit	-	104.52	111.16
Provigjonet teknike bruto	-	121.22	99.07
Detyrime të tjera	-	93.43	98.13
Kapitalet e veta	-	96.75	121.85
Totali i Pasivit	-	104.52	111.16

Përmbledhja e totalit të pasqyrës së bilancit për periudhat 31.12.2008, 2009 dhe 2010 mbulon shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës dhe Jetës. Raportimi i pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në mbështetje të bazës rregulative të Autoritetit.

Gjatë analizës së gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit, për vitin 2010, u vu re se:

Totali i aktivitet të tregut të sigurimeve për vitin 2010 sipas pasqyrave financiare, arriti vlerën 18.04 mld lekë. Krahasuar me 31.12.2009, totali i aktivitet u rrit me 1.81 mld lekë. Investimet në depozita në banka zënë pjesën më të madhe të totalit të aktivitet me 50.84%. Rritja e zërit Investime gjatë vitit 2010, kryesisht vihet re në depozita, pasuri të paluajshme, aksione dhe pjesëmarrje, bono thesari.

Tabelë 7: Disa Karakteristika mbi Tregun e Sigurimeve

(në mln lekë)

<i>Periudha Ushtrimore</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>
Totali i aktiveve	11,453	13,360	15,525	16,227	18,039
Jeta	1,171	1,401	1,841	2,919	2,473
Jo-Jeta	10,282	11,959	13,684	13,308	15,566
Totali i investimeve	8,014	9,255	11,182	10,830	11,855
Jeta	973	1,071	1,389	2,101	1,832
Jo-Jeta	7,041	8,184	9,793	8,729	10,023
Provizjonet teknike bruto	5,518	5,929	5,138	6,229	6,171
Jeta	218	227	233	361	644
Jo-Jeta	5,300	5,702	4,905	5,868	5,527
Totali i kapitalit	5,557	6,956	8,832	8,546	10,413
Jeta	926	1,247	1,541	1,754	1,763
Jo-Jeta	4,632	5,709	7,291	6,792	8,649
Totali i kapitalit të nënshkruar	3,788	5,191	6,031	5,787	6,684
Jeta	868	1,001	1,248	1,097	1,278
Jo-Jeta	2,920	4,190	4,783	4,690	5,406
Totali i investimeve të huaja	1,149	2,378	2,924	1,985	3,587
Jeta	215	379	460	355	347
Jo-Jeta	933	1,999	2,463	1,630	3,240
Primet e shkruara bruto	4,542	5,948	7,076	7,877	8,207
Jeta	302	410	515	721	848
Jo-Jeta	4,239	5,538	6,561	7,156	7,359
Primi i fituar neto	3,910	4,705	5,543	6,092	6,680
Jeta	241	357	459	469	636
Jo-Jeta	3,669	4,348	5,083	5,596	6,044
Dëmet e paguara bruto	1,287	1,294	1,571	1,733	2,289
Jeta	12	44	45	79	72
Jo-Jeta	1,275	1,250	1,526	1,654	2,217



Treguesit Financiarë IRIS

Në kuadrin e punës së Autoritetit për ngritjen e një tregu financiar të stabilizuar dhe në kuadrin e projektit të Autoritetit në bashkëpunim me Bankën Botërore, me synim kalimin në drejtim të metodës së mbikëqyrjes me fokus riskun, gjatë vitit 2010 ka vazhduar të zbatohet sistemi i paralajmërimit të hershëm.

Kështu, në analizën e gjendjes financiare të sektorit të sigurimeve, në vlerësimin e shoqërive, përdoren edhe treguesit e sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve) të përshtatura për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës në Shqipëri.

Këto tregues financiarë i shërbejnë evidentimit në kohën e duhur të problemeve që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg.

Tabelë 8: Diapazonet e vlerave të treguesve financiarë IRIS

Raporti	31.12.2008 ¹	31.12.2009 ¹	31.12.2010	Kufiri (%)	
				MIN	MAX
Norma e rritjes së primit	18.84%	9.07%	2.73%	-40	40
Raporti i mbajtjes neto	79.50%	82.16%	84.37%	40	80
Raporti dëme/prime neto	25.70%	36.24%	32.86%	50	80
Raporti i shpenzimeve	67.12%	70.28%	62.28%	25	50
Raporti i kombinuar	92.82%	106.52%	95.14%	85	105
Te ardhurat nga investimet	5.82%	7.14%	8.04%	4	8
Raporti i kapitalit	62.42%	51.92%	71.16%	20	50
Raporti i provigjoneve teknike	88.89%	73.52%	98.34%	10	30
Raporti i aftësisë paguese	315.98%	374.40%	447.92%	150	300

Shënim: 1) Në vitin 2008 filloi zbatimi i IFRS-ve. Zbatimi i tyre u pasua me ndryshimet përkatëse në mbajtjen e disa llogarive të bilancit dhe formës së paraqitjes së tyre.

Primet e shkruara bruto për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës gjatë vitit 2010, arritën në vlerën 8.2 mld lekë, nga të cilat 7.4 mld lekë për Jo-Jetën dhe 0.8 mld lekë për Jetën. Primet e shkruara bruto janë rritur në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Norma e rritjes së primeve të tregut të sigurimeve është brenda kufijve të përcaktuar, ndonëse ka tendencë në rënie. Kështu, në 2010, norma e rritjes së primeve të Jo-Jetës është 2.73%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (është 6.34 pikë përqindje më e ulët se ajo e vitit të kaluar).


Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës karakterizohet nga një Raport i lartë i mbajtjes neto në masën 84.37% për vitin 2010. Normat e përcaktuara ndërkombëtare rekomandojnë vlera midis 40-80%.

Raporti dëme/prime për shoqëritë e Jo-Jetës, vijon të mbetet në nivele të ulëta ndonëse që nga viti 2009 është në masën mbi 30%.

Raporti i shpenzimeve, është përmirësuar gjatë vitit 2010 (me 8 pikë përqindje), ndonëse vijon të jetë mbi nivelet e përcaktuara për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në Shqipëri. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zënë shpenzimet operative të veprimtarisë në masën 66% për tregun e Jo-Jetës.

Raportet financiare të mësipërme jepen më poshtë në mënyrë grafike për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës. Këto raporte i takojnë vitit financiar 2010.

Treguesit IRIS 2010





Inspektime në vend (on-site) në subjektet e mbikëqyrura

Inspektimi në vend (on-site) është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes. Ky proces ka si qëllim zbulimin, parandalimin e shkeljeve ligjore, parregullsive, gabimeve dhe fakteve të konstatuara dhe marrjen e masave në kohë të përshtatshme për korrigjimin e tyre. Inspektimi në vend shërben për të garantuar dhe siguruar që subjektet e mbikëqyrura ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe objektin e veprimtarisë së tyre.

Objektivi kryesor i çdo inspektimi on-site është vlerësimi i aftësisë paguese aktuale dhe të pritshme të shoqërisë. Në mënyrë specifike, objektivi i këtij inspektimi është të krahasojë profilin e riskut të shoqërisë, me kapacitetin e mbajtjes së tij dhe të identifikojë çdo problem që mund të influencojë në aftësinë e shoqërisë për t'ju përgjigjur detyrimeve afatgjata të policëmbajtësve.

Objektivat kryesore të inspektimit on-site

- Vlerësimi i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me bazën ligjore në fuqi.
- Vlerësimi i politikave të ndjekura nga subjektet e mbikëqyrura mbi trajtimin ligjor dhe korrekt të konsumatorit.
- Vlerësimi i gjendjes financiare të këtyre subjekteve.
- Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të riskut.
- Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Vlerësimi i sigurisë së sistemeve të informacionit për raportimet elektronike në AMF sipas kërkesave ligjore.
- Identifikimi i transaksioneve të pazakonta jashtë objektit të veprimtarisë së licencuar të këtyre subjekteve.

Në varësi nga çështjet që do të inspektohen, inspektimi në vend mund të përfshijë një tematikë të gjerë duke u shtrirë mbi gjithë aktivitetin e subjektit, ose mund të fokusohet në problematika të veçanta, të cilat i nënshtrohen inspektimit në vend tematik, ose me objekt të kufizuar.

Monitorimi dhe analizimi i të dhënave financiare dhe statistikore të raportuara nga operatorët e tregut, raportet e shoqërive audituese, raportet e komitetit të kontrollit të brendshëm dhe aktuarëve, informacioneve të tjera nga palë të treta, ndihmojnë në planifikimin e inspektimeve në vend tek subjektet e mbikëqyrura për të evidentuar risqet e këtyre subjekteve dhe për të punuar për mbajtjen e tyre brenda kufijve të pranueshëm.

Kryerja e inspektimeve on-site tek subjektet e mbikëqyrura, kryhet mbi bazën e një programi, i cili hartohet në përputhje me problematikat të cilat kërkohet të inspektohen. Ky

program përmban një prezantim të shkurtër të objektivave që synon inspektimi, formën e tij, subjektin që do të inspektohet, kohëzgjatjen e inspektimit dhe përbërjen e grupit të inspektimit. Programi i inspektimit mund të ndryshojë ose zgjerohet objekti i tij, nëse gjatë këtij procesi vlerësohet e arsyeshme arritja e konkluzioneve sa më të drejta për subjektin e inspektuar.

Gjatë vitit 2010, Drejtoria e Inspektimit, në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të Autoritetit, me Drejtorinë e Analizës dhe Raportimit Financiar, me Departamentin e Kërkimit, TI dhe Statistikës, ka kryer 21 inspektime në vend, nga të cilat 10 inspektime të plota dhe të planifikuara, 8 inspektime tematike të planifikuara, 2 inspektime tematike të pa planifikuara dhe 1 inspektim të përbashkët.

Inspektime në subjektet e mbikëqyrura

Inspektimi i pasqyrave financiare

Këto inspektime konsistuan në verifikimin në vend të çështjeve apo problemeve që kanë dalë gjatë analizës të pasqyrave financiare periodike të shoqërive të sigurimit, si edhe nga çështje të veçanta që kërkonin verifikim të mëtejshëm dhe të menjëhershëm.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të vlerësuar gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit, ka ushtruar inspektime të plota dhe të planifikuara në 10 shoqëritë e sigurimit (Jetë dhe Jo-Jetë) me qëllim:

- verifikimin në vend të aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të shoqërive të sigurimit për vitin 2009 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2010;
- verifikimin e drejtimeve të investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike sipas kategorive dhe limiteve të lejueshme të investimit të përcaktuar në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe aktet nënligjore;
- evidentimin e aktiveve jo të lira, të cilat nuk konsiderohen aktive në mbulim të provigjoneve teknike;
- vlerësimin e cilësisë së aktiveve dhe nivelin e likuiditetit të tyre;
- vlerësimin e nivelit të përgjegjësisë të marra në sigurim nga ana e shoqërive të sigurimit dhe marrëveshjeve të risigurimit, në zbatim të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" si dhe akteve përkatëse nënligjore.

Pjesë e rëndësishme e inspektimit të shoqërive të sigurimit ka qenë edhe verifikimi i të dhënave të Regjistrit të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike dhe siguria e sistemeve të informacionit.

Lidhur me teknologjinë e informacionit, shoqërive iu kërkua raportimi i sistemeve informatike në përdorim të shoqërive, të tillë si:



- sistemi i shitjeve të policave të sigurimit, trajtimit të dëmeve, sistemet financiare, etj;
- lidhjet e rrjetit në përdorim të shoqërive, partnerëve apo palëve të treta;
- sistemet hardware kryesorë në përdorim të shoqërive, partnerëve apo palëve të treta;
- procedurat mbi politikat e sigurisë që zbatohen për përdoruesit e sistemeve informatike të shoqërive;
- procedurat e backup-it të të dhënave sensitive dhe të rëndësishme për vazhdimësinë e punës së shoqërive, si dhe;
- dokumentacion mbi punonjësit e përfshirë në menaxhimin e sistemeve informatike të shoqërive.

Konkluzionet dhe rekomandimet që rezultuan nga inspektimet e kryera, shërbyen si bazë për analizën e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit për vitin 2009 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2010.

Inspektim i përbashkët

Në korrik 2010, AMF, në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë ka kryer inspektim të përbashkët tematik në bankat e nivelit të dytë me qëllim:

- verifikimin në vend të kontratave të shprehura, si sigurim garancie të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit, për të evidentuar përfituesin dhe kushtet e kontratave, me qëllim përcaktimin e klasës së sigurimit;
- verifikimin e depozitave të bllokuara të shoqërive të sigurimit;
- verifikimin e kredive të marra nga shoqëritë e sigurimit pranë bankave të nivelit të dytë, kolaterale të garantuara prej tyre, si edhe certifikatat e garancive për sigurim kontrate.

Në kuadër të marrjes dhe kryqëzimit të informacionit të nevojshëm për ushtrimin e mbikëqyrjes, një bashkëpunim i suksesshëm ka rezultuar edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Mbështetur në gjetjet, problematikën apo mangësitë e konstatuara nga këto inspektime, Bordi i AMF-së, mori vendime që kishin të bënin me marrjen e masave apo vendosjen e sanksioneve ndaj shoqërive të sigurimit, si dhe me dhënien e rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit.

Inspektime të tjera në vend

Në vitin 2010, janë kryer 8 inspektime tematike të planifikuara në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës lidhur me dëmet e paguara dhe të mbetura pezull për vitin 2009 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2010.

Këto inspektime u përqendruan në verifikimin e procedurave të ndjekura nga shoqëritë e sigurimit në procesin e trajtimit të dëmeve, që rrjedhin nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik, vlerësimit dhe pagesës së

dëmeve, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Rregullores së AMF-së nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”. Pjesë e këtij inspektimi ishin edhe verifikimi i procedurave të ndjekura për praktikën e dëmeve të refuzuara, duke shqyrtuar shkaqet e paraqitura nga shoqëria për refuzimin e kërkesave për dëmshpërblim, verifikimin e praktikave të dëmeve pezull dhe atyre në proces gjyqësor.

Një rol të rëndësishëm në trajtimin me korrektësi dhe të paanshëm të konsumatorit kanë luajtur hartimi dhe miratimi i Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Rregullores së AMF-së nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Rregullorja e AMF-së nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e cila është miratuar në zbatim të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave të trajtimit të dëmeve, që mbulohen nga kontrata e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, të përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, të përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të avionit, për dëme shkaktuar palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni, të përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit lundrues, për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

AMF, në vazhdimësi gjatë vitit 2010, ka ushtruar edhe inspektime të tjera tematike në shoqëritë e sigurimit, me qëllim verifikimin fizik të pasurive të paluajtshme të tyre, si dhe pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS), në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Masat korrigjuese dhe administrative

Një treg financiar i qëndrueshëm, efikas dhe transparent me operatorë të shëndoshë financiarisht arrihet nëpërmjet shtimit apo forcimit të masave mbikëqyrëse.

Masat e marra nga Autoriteti përbëjnë një strategji të përcaktuar, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve të subjekteve të mbikëqyrura në kohën e duhur, duke siguruar një stabilizim dhe qëndrueshmëri financiare.

Kjo strategji përmban përshkallëzim të masave në mënyrë të tillë, që sa më i pafavorshëm të ketë qenë profili i riskut, aq më e madhe ka qenë shkalla e ndërhyrjes së mbikëqyrjes dhe me të mëdha kanë qenë masat korrigjuese dhe sanksionet me gjobë, si mjete të papajtueshmërisë apo të sigurimit të kthimit në gjendje të sigurt dhe të shëndoshë.



Masat mbikëqyrëse ku përfshihen masat korigjuese dhe gjobat janë vendosur nga Autoriteti në mënyrë të paanshme dhe transparente.

Marrja e masave bazohet në inspektimet në vend apo kontrollin mbi dokumenta, hetim të informacionit, apo ankesave të depozituara.

Autoriteti ka punuar me kujdes në drejtim të njohjes dhe identifikimit të riskut, duke iniciuar masa përkatëse, me qëllim zbatimin e tyre në praktikën e përditshme. Këto konstatime përfshijnë shkelje të dispozitave të ligjit në lidhje me qëndrueshmërinë financiare, rregullat e menaxhimit të rrezikut, raportime të sakta dhe në kohë, organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sistemit të dëmshpërblimit, etj.

Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime" parashikon masa administrative si më poshtë:

- Urdhër për eliminim shkeljesh
- Masa korigjuese
- Plan financiar
- Gjobë subjektiv
- Gjobë personit përgjegjës
- Tërheqje licence
- Administrim i përkohshëm
- Likuidim

Gjatë vitit 2010, nga mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit, janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore dhe janë marrë masa administrative. Masat e vendosura ndaj subjekteve të mbikëqyrura kanë ndikuar në një përmirësim të qëndrueshmërisë financiare të disa subjekteve, si dhe kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut.

Masa administrative të marra nga AMF ndaj shoqërive të sigurimit

Masa korigjuese, për:

- plotësimin e aftësisë paguese;
- zotërimin e aktiveve të përshtatshme në mbulim të provigjoneve teknike;
- financimin e Fondit të Kompensimit;
- plotësimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil;
- ndalimin e transaksioneve me palë të lidhura;
- kufizimin e depozitave bankare të bllokuara.

Masa për mosraportim të saktë në Autoritet, për:

- përgjegjësitë e marra;
- pasqyrat financiare.

Paralajmërim për tërheqje licence

Sanksion me gjobë, për:

- mos depozitim brenda afatit të raportit të auditorit.

Tabelë 9: Masa administrative të marra nga AMF ndaj shoqërive të sigurimit viti 2010*

Masa korigjuese	17
Urdhër për raportim	8
Sanksion me gjobë	1
Plan masash financiare	1
Paralajmërim për tërheqje licence	2
Kufizim shpërndarje fitimi	2

Shënim: Masat janë marrë nga konstatimet e analizës financiare të vitit 2009, të 6-mujorit të parë të vitit 2010 dhe detyrimin e shoqërive të sigurimit për financimin e Fondit të Kompensimit.

Institutet private të pensioneve

Me qëllim sigurimin e mbikëqyrjes në fushën e tregut të pensioneve vullnetare, gjatë vitit 2010, është monitoruar veprimtaria e instituteve të pensionit vullnetar që operojnë në këtë treg. Nga mbikëqyrja e kryer, është konstatuar se këto institute plotësojnë treguesit e nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Gjithashtu, institutet e pensioneve vullnetare janë në proces të plotësimit të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", i cili ka hyrë në fuqi në datë 15.01.2010. Në këtë ligj, ndër të tjera, përcaktohet se institutet ekzistuese të pensioneve duhet të paraqesin kërkesë për licencë brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar". Instituti privat i pensioneve "Raiffeisen Pension" sh.a është licencuar sipas dispozitave të ligjit të ri, ndërsa 2 institutet e tjera ekzistuese janë në proces licencimi sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin në fjalë.

Autoriteti, gjatë vitit 2010, ka marrë pjesë në procese gjyqësore si në rastet e ankimimeve të vendimeve të bordit, ashtu dhe si palë e tretë e thirrur nga Gjykata në lidhje me sistemin e dëmshtëpërblimeve, që rrjedhin nga kontrata e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik.



Tabelë 10: Përmbledhëse e proceseve gjyqësore në lidhje me masat administrative të marra nga AMF, deri më 31.12.2010

<i>Procese gjyqësore në total*</i>	9
<i>Të mbartura nga vitet paraardhëse</i>	7
Gjykatë e Lartë	6
Gjykatë e Apelit	1
Gjykatë e Shkallës së Parë	-
<i>Të ankimuar gjatë vitit 2010</i>	2
Gjykatë e Shkallës së Parë	2

*Shënim**: Në lidhje me çështjet gjyqësore që janë në gjykim, 6 prej tyre kanë për objekt ankimim sanksione me gjobë, 1 ka për objekt ankimim masë korrigjuese dhe 1 ka për objekt ankimim refuzim licencë për broker.

Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)

Autoriteti, në bazë të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, mbikëqyr Byronë Shqiptare të Sigurimit.

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- garantimi i funksionimit të detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi i Byrosë në sistemin e Kartonit Jeshil;
- zbatimi i detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit;
- zbatimi i detyrimeve të tjera ligjore që lidhen me veprimtarinë e BSHS-së.

Realizimi i mbikëqyrjes:

- nëpërmjet raportimeve periodike të Byrosë;
- nëpërmjet inspektimeve tematike kur e shih të nevojshme.

Autoriteti ka ndjekur me përparësi detyrimet e shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë për financimin e Fondit të Kompensimit dhe Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil, duke marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së BSHS-së dhe duke organizuar takime të përbashkëta me drejtuesit e shoqërive të sigurimit dhe drejtorin e BSHS-së. Gjatë vitit 2010, nga shoqëritë e sigurimit janë konstatuar vonesa në plotësimin e detyrimeve ndaj Byrosë, gjë që ka sjellë dhe marrjen e masave administrative ndaj tyre.

2.4 Teknologjia e informacionit

Teknologjia e Informacionit (TI) në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare është në zhvillim të vazhdueshëm si pjesë e pandarë e institucionit, duke pasur si objekt pune dhe strategji zhvillimi, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike. Viti 2010 është karakterizuar nga një zhvillim cilësor në infrastrukturën e sistemeve informatike lidhur me krijimin e qendrës dytësore të mbajtjes së të dhënave dhe zhvendosjen në qendrën primare. Hapat e cilësuar u zhvilluan me sukses pa krijuar ndërprerje shërbimi ndaj të tretëve. Si rezultat, infrastruktura TI e Autoritetit është ndër më të avancuarat në shkallë vendi.

Gjatë vitit 2010 janë zhvilluar aktivitete, me qëllim përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve të tij, mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe aktivitete për projektimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike të brendshme të Autoritetit. Në kuadër të përmirësimit të aktivitetit të brendshëm, TI siguron administrimin e vazhdueshëm në nivel aplikimi, baza të dhënash, menaxhimin e sigurisë dhe ndihmën e vazhdueshme teknologjike për punonjësit e institucionit.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Gjatë vitit 2010 përveç sigurimit të vazhdimësisë së funksionimit të regjistrave elektronikë, janë realizuar edhe ndryshime strukturore, me qëllim optimizimin e aplikacioneve përbërëse dhe rritjen e shkallës së sigurisë e vazhdueshmërisë së shërbimeve nëpërmjet krijimit efektiv të dy qendrave: parësore dhe dytësore. Në Qendrën Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik një rol të rëndësishëm në të ardhmen do të ketë dhe mundësimi i sistemit Bonus-Malus, me fokusim të veçantë mbi një liberalizim të mundshëm të tarifave ose kalim të mirëfilltë në përjasjen me bazë risku. Gjatë vitit 2010 është saktësuar zgjidhja teknike dhe integrimi i saj me Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike dhe Regjistrin e Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik është realizuar nga Autoriteti nëpërmjet Drejtorisë TI në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit dhe përbëhet nga:

- Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi dhe identifikimi në kohë reale i shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar;



- Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi i dëmeve të ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike. Për të mundur fazën e tretë të projektit, krijimin e sistemit Bonus-Malus, Regjistri i Dëmeve është plotësuar me të dhënat historike të dëmeve, nga janari 2006.

Objektivat

Në kuadër të projektit të përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, për vitin 2011, janë parashikuar:

- shtesa në Regjistrin Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike si funksione në shërbim të konsumatorëve në përgjithësi dhe tregut e shoqërive të sigurimit në veçanti. Ndër shtesat më të rëndësishme bën pjesë edhe mundësimi i shfaqjes automatike të të dhënave të mjeteve motorike dhe të pronarëve të tyre tek agjentët e shitjes, duke mundur uljen e kohës së lëshimit të policës, saktësimin e të dhënave dhe evitim të rasteve të pasaktësive ose keq përdorimeve të mundshme. Kjo do të mundësohet efektivisht edhe në sajë të bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Transportit nëpërmjet lidhjes në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor;
- të dhëna në Regjistrin Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike, të cilat do të shërbejnë për kontrollin e mundshëm në kohë reale. Në shërbim të konsumatorëve përveç shërbimit të dhënë nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, do të ngrihen edhe shërbimet e konsultimit të vlefshmërisë së policës me anë të mesazheve SMS dhe telefonit. Kjo ka një rëndësi të veçantë si për industrinë, ashtu dhe për konsumatorët;
- shtesa në Regjistrin e Dëmeve si funksione në shërbim të shoqërive të sigurimit, raporte në shërbim të Autoritetit dhe funksione në shërbim të mirëmbajtjes së tij;
- të dhëna në dispozicion, si rezultat i fazës së parë dhe të dytë të projektit që do të përdoren si parametra në algoritmin Bonus-Malus, i cili është i gatshëm për t'u realizuar gjatë vitit 2011.

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit

Në kuadër të përmirësimit të raportimit elektronik të subjekteve në mbikëqyrje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me ndihmën financiare të Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) po zhvillon projektin "Management Information System" (MIS) në bashkëpunim me shoqërinë e zhvillimit të produkteve të raportimit "VIZOR". Projekti nga ana teknike përbëhet nga një platformë raportimi web, nëpërmjet të cilës operatorët e shoqërive të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së internetit.

Drejtoria TI, si pjesë e grupit të punës që menaxhon projektin, gjatë vitit 2010 ka marrë pjesë intensive në procesin e vënies në funksionim, saktësimin të funksionimit dhe ndërtimit të pjesëve të reja të sistemit si forma e raporte.

Sistemi tashmë është i instaluar në sallën e serverave të Autoritetit dhe në përdorim nga shoqëritë raportuese. Një punë e veçantë është kryer në drejtim të identifikimit dhe realizimit të specifikave për të mundësuar vazhdimësinë e veprimtarisë së sistemit dhe strategjinë e “disaster recovery”.

Sistemi Telefonik i Ndhmës së Konsumatorëve

“Sistemi Telefonik i Ndhmës së Konsumatorëve” është modifikuar dhe përshtatur nëpërmjet konfigurimit të sistemit të përgjigjes automatike, në të cilin përfundojnë telefonatat nga numri telefonik i konsumatorit “+355 4 2269 329” i publikuar në faqen zyrtare të internetit www.amf.gov.al dhe nga numri pa pagesë “0800 6969”.



The screenshot shows the AMF In-Reg Firms website interface. At the top, there is a navigation bar with the AMF ALBANIA logo and the text "AMF In-Reg Firms". Below the navigation bar, there is a search bar and a "Shqip" dropdown menu. The main content area is titled "Mirë se Erdhët në AMF In-Reg Firms" and contains a welcome message and a login form. The login form has two input fields: "Emri i përdoruesit:" and "Fjalëkalim:". Below the input fields is a "Hyrje" button. At the bottom of the form, there is a link "Fjalëkalim i Harruar".

Gjatë vitit 2011, si zhvillim i mëtejshëm i sistemit, do të mundësohet kontrolli i sigurimit të mjetit direkt nga telefoni. Personave të interesuar do t'u kërkohet të shtypin në tastierën e telefonit targën e mjetit dhe do të informohen mbi saktësinë e tyre.

Sistemi SMS i mbështetjes së Konsumatorëve

Gjatë vitit 2010 është projektuar “Sistemi SMS i ndihmës së Konsumatorëve”. Sistemi mundëson kontrollin e policës së sigurimit dhe rikujtesën automatike nëpërmjet dërgimit të mesazhit SMS në datën e përfundimit të periudhës së sigurimit. Sistemi do të vihet në përdorim gjatë vitit 2011.



Platformat dhe sistemet e AMF-së garantojnë:

Në drejtim të mbikëqyrjes:

- monitorimin në kohë reale të shoqërive të sigurimit në shitjen e policave të sigurimeve të detyrueshme dhe të dëmeve motorike;
- kontrollin e korrektësisë së policave nga vetë klientët;
- automatizimin e proceseve të punës dhe rritjen e efektivitetit të vendimmarrjes;
- minimizimin e gabimeve teknike nëpërmjet njësimit të përdorimit të platformave të ndryshme nga AMF dhe operatorët e mbikëqyrur;
- parametra të lartë të sigurisë, si nga ana fizike dhe funksionale.

Në drejtim të efektivitetit të punës së institucionit:

- standardizimin e infrastrukturës së rrjetit dhe të menaxhimit informatik të posteve të punës;
- forcimin e shkallës së sigurisë së informacionit, duke marrë parasysh sistemet kritikë të ndërtuar dhe konfidencialitetin e të dhënave, nëpërmjet rritjes të sigurisë të infrastrukturës informatike dhe aplikimit të rregullave në aksesin dhe përdorimin e brendshëm;
- licencimin software për aktivitetin informatik të AMF-së në bashkëpunim dhe sipas direktivave të institucioneve dhe rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- përdorimin e “paketave software” të standardizuara në aktivitetin financiar të AMF-së dhe të njohura nga organet e kontrollit apo ato tatimore, duke bërë më transparent funksionimin e vetë Autoritetit;
- informatizimin e vazhdueshëm të arkivës, si dhe dokumentacionit të protokolluar për të lehtësuar dhe mundësuar vazhdueshmërinë e përpunimit të materialeve me afate shqyrtimi relativisht të gjata;
- automatizimin e procesit të vendosjes së të dhënave, nëpërmjet integritit të produkteve më të avancuara, me rrjedhojë efektivitetin e lartë në përdorimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e tyre profesionale.

2.5 Bashkëpunimi institucional

Bashkëpunimi me institucionet e vendit

AMF, edhe gjatë vitit 2010, ka forcuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në përmbushje të misionit të **Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar**, me qëllim rritjen e efektivitetit të rregullimit të tregjeve financiare në Shqipëri.

Vlen të përmendet, në kuadër të ruajtjes së stabilitetit financiar, përgatitja e një draft

memorandumi bashkëveprimi ndër institucional, që vendos përgjegjësitë e **Ministritë së Financave, Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave** në raste krizash të mundshme financiare, duke sugjeruar një mënyrë të mundshme veprimi, për një reagim të koordinuar dhe efektiv të tyre.

Bashkëpunimi me **Ministrinë e Financave** edhe gjatë vitit 2010 ka qenë tepër i rëndësishëm dhe i suksesshëm. Në këtë aspekt vlen të theksohet bashkëpunimi mes Autoritetit dhe Ministrisë së Financave për mënyrën e zbatimit të politikave mbi lehtësitë tatimore të sanksionuara në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe në drejtim të përcaktimit të roleve dhe përgjegjësisive të secilës palë në procesin e emetimit të eurobondit të parë.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional me **Ministrinë e Transportit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor**, gjatë vitit 2010, është projektuar sistemi i integritit të ndërsjellë të bazave të të dhënave në përkatësi. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve, do të mundësojë zbatimin dhe kontrollin e legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me dokumentacionin e nevojshëm ligjor, zvogëlimin e numrit të mjeteve motorike të pasiguruara apo të pakolauduara.

Me **Bankën e Shqipërisë**, bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm në drejtim të arritjes së objektivave të përbashkëta për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare në vend. Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit midis dy institucioneve dhe inspektimet e përbashkëta kanë rezultuar të suksesshme, duke konfirmuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi strategjik në drejtim të evidentimit të risqeve dhe transferimit të tyre brenda sektorit financiar.

Me **Autoritetin e Konkurrencës**, bashkëpunimi ka konsistuar në takime të vazhdueshme si në nivel teknik ashtu dhe me pjesëmarrjen e komisionerëve të Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e Bordit të AMF-së. Çështjet e diskutuara me Autoritetin e Konkurrencës lidhen me tregtimin e produkteve të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike, ngritjen e njësisë së mbrojtjes konsumatore për tregun e letrave me vlerë.

Autoriteti ka mbajtur kontakte të rregullta me **Ministrinë e Integritit Evropian** dhe ka përcjellë raporte, të cilat pasqyrojnë progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, si dhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë me acquis të akteve juridike të miratuara në fushën e tregut financiar jo-bankar.



Konkretisht:

- raportim çdo 2 muaj pranë (me ndërmjetësimin e Ministrisë së Integritit) Komunitetit Evropian, në lidhje me zhvillimet legislative, masat dhe projektet e kapacitetet institucionale në lidhje me periudhën raportuese;
- raportim mujor në sistemin online në kuadër të PKZMSA-së dhe raportim e rishikim periodik të Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, me një fokus të veçantë në aspektet që lidhen me afatet e përcaktuara sipas detyrimeve të MSA-së, si dhe adresimin e problematikës e rekomandimeve të Raport Progresit të Komisionit Evropian;
- raportim i vazhdueshëm në lidhje me fushat e mbikëqyrura dhe të rregulluara nga AMF, duke ju dhënë përgjigje pyetjeve dhe kërkesave të ndryshme, të cilat i drejtohen Autoritetit nga Komisioni Evropian;
- raportim vjetor në lidhje me të gjitha zhvillimet e tregut të sigurimeve, të titujve apo pensioneve private të mbikëqyrura nga AMF për periudhën raportuese në fjalë;
- rishikim dhe përditësim me legjislacionin më të fundit komunitar në fushën e tregjeve të rregulluara dhe mbikëqyrura nga Autoriteti.

Autoriteti ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Integritit Evropian edhe në kuadër të procesit të dhënies së përgjigjeve të Pyetësorit të BE-së. Ky proces bashkëpunimi ka konsistuar në parapërgatitjen për dhënien e përgjigjeve, duke vazhduar me plotësimin dhe përfundimin e përgjigjeve të Pyetësorit, me qëllim koordinimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi. Pas dorëzimit të Pyetësorit, bashkëpunimi ka vazhduar nëpërmjet takimeve apo trajnimeve të organizuara nga MIE në kuadrin e rekomandimeve të Raportit Analitik të KE-së.

Autoriteti është anëtar i grupit teknik të zbatimit të **Dokumentit Strategjik Kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”**. Nëpërmjet këtij dokumenti synohet krijimi i një platforme afatgjatë veprimi për të vendosur një ekuilibër ndërmjet parandalimit efektiv dhe hetimeve të krimeve në fushën ekonomiko-financiare. Për zbatimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për integrimin e vendit është hartuar një plan veprimi për periudhën 2009-2015, ku janë përcaktuar objektiva afatmesme dhe afatgjata, si dhe prioritet dhe aktivitetet, të cilat do të sigurojnë përmbushjen e tyre. Në këtë kuadër, AMF raporton çdo tre muaj pranë DPPPP*, për ecurinë e realizimit të objektivave të dokumentit strategjik.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet financiare vendase, vlen të përmendet nënshkrimi i marrëveshjes midis **AMF** dhe **Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP)**, më 3 nëntor 2010.

Nënshkrimi i marrëveshjes shërben si bazë bashkëpunimi midis dy institucioneve. Qëllimi i saj është përcaktimi i procedurës dhe vendosja e rregullave të bashkëpunimit midis dy institucioneve, në mënyrë që të sigurohet shkëmbimi i informacionit lidhur me zbatimin e kodit të etikës dhe standardeve profesionale siç përcaktohen në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit e standarde të tjera përkatëse nga ana e ekspertëve kontabël të regjistruar, kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të auditit që kryejnë auditimin e shoqërive të mbikëqyrura nga Autoriteti. Kjo marrëveshje do të ndikojë në përmirësimin e

Sqarim - DPPPP* - Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

nivelit të sigurisë nga auditimet ligjore, si dhe do të rrisë nivelin e cilësisë nga shërbimet kontabël në kushtet e një mjedisi transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm në përputhje të plotë me interesat e publikut duke respektuar pavarësinë dhe nderin e anëtarësisë profesionale, si dhe kërkesat e ruajtjes së konfidencialitetit sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

AMF mban një komunikim të vazhdueshëm me homologët nëpërmjet kontakteve dhe shkëmbimit të eksperiencës. Pjesëmarrja gjithnjë e më aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë është një domosdoshmëri në njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit rregullative dhe mbikëqyrëse, si dhe zbatimin e parimeve dhe praktikave më të mira. Një tjetër faktor i rëndësishëm në intensifikimin e kontakteve me homologët dhe institucionet ndërkombëtare ka qenë dhe nevoja e harmonizimit të legjislacionit rregullues të tregjeve financiare jo-bankare me Direktivat e BE-së, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

Marrëdhëniet me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO)



Zj. E.Gjoni dhe zyrtarë të lartë të AMF-së gjatë Konferencës së 35-të Vjetore të IOSCO-s

Si në vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2010, AMF ka vazhduar bashkëpunimin teknik me shumë autoritete homologe në fushën e letrave me vlerë nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca, seminare, etj. si një domosdoshmëri për përditësimin e marrjen e eksperiencave të vendeve të zhvilluara.

Autoriteti merr pjesë rregullisht dhe në mënyrë aktive në mbledhjet Vjetore të Përgjithshme të IOSCO-s që shërbejnë si një forum për shkëmbimin e pikëpamjeve në fushën e ruajtjes dhe përmirësimit të kuadrit rregullator

ndërkombëtar të tregjeve të letrave me vlerë përmes vendosjes së standardeve ndërkombëtare, identifikimit dhe trajtimit të rreziqeve të sistemit, çuarjen përpara të përbushjes së Objektivave dhe Parimeve të Rregullimit të Letrave me Vlerë të IOSCO-s, si dhe në ndjekjen e zbatimit të plotë të Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s për konsultimet, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit. Gjithashtu, AMF, e përfshirë edhe në Komitete dhe struktura të veçanta të IOSCO-s rajonale e më gjerë ndjek e punon në kuadrin e tyre në mënyrë profesionale.



Më datën 6-10 qershor 2010, Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO), zhvilloi Konferencën e 35-të Vjetore, në Montreal, Kanada. AMF u përfaqësua në këtë eveniment nga zyrtarë të lartë të Institucionit, kryesuar nga Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e Autoritetit.

Marrëdhëniet me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

AMF si anëtare e IAIS-it (Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve) që prej vitit 2001, është duke ndjekur me interes procesin e filluar nga IAIS për nënshkrimin nga vendet anëtare, të Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit (MMoU) me IAIS. Kjo është një marrëveshje për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit e vendosur nga anëtarët e IAIS, me qëllim vendosjen e standardeve minimale për të forcuar mbikëqyrjen ndërkufitare të shoqërive të sigurimit. Pjesëmarrja në këtë marrëveshje multilaterale është një mjet i rëndësishëm rregullator për të siguruar një mbikëqyrje të shëndoshe të tregut të sigurimeve. Natyra në zhvillim e tregut të sigurimeve me kompanitë e sigurimeve gjithnjë e më shumë në zgjerim e operacionet e tyre në nivel global, si dhe kriza financiare e shoqëruar me sfida të reja, kanë bërë që AMF ta konsiderojë atë si një hap të rëndësishëm strategjik në axhendën e saj.



Zyrtarë të lartë të AMF-së, gjatë Konferencës së 17-të vjetore të IAIS-it

Edhe gjatë vitit 2010, AMF vijon të jetë pjesëmarrëse me kontribut aktiv, në Nënkomitetin e Bazës së të Dhënave të Ligjeve të IAIS-it, i cili lidhet me shkëmbimin e përvojave të vendeve të ndryshme, hartimin dhe njësimin e standardeve për t'u zbatuar më tej nga të gjithë vendet anëtare.

Marrëdhëniet me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)

Anëtarësimi në IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve) është një angazhim që AMF e ka vlerësuar vazhdimisht. Synimi ka qenë të ndihmonte në shumë aspekte në krijimin e urave të bashkëpunimit në nivel global në mes të gjithë palëve të interesuara për sistemin e pensioneve. Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të AMF-së në mbledhjen vjetore e takime të tjera rajonale, si dhe në seminare, ka ndihmuar në njohjen me praktikat më të mira në fondet e pensioneve dhe promovimin e qasjeve të reja të bazuara në risk në mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve.

Bashkëpunimi me institucione homologe

Mbajtja e komunikimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit me institucionet homologe të rajonit e më gjerë, janë të domosdoshme në drejtim të përmbushjes së rolit rregullativ të AMF-së, për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jo-bankare.

Bashkëpunimi me **Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK)**, ka hyrë në një fazë konsolidimi dhe luan një rol tepër të rëndësishëm, sidomos në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në të dy vendet, pasi shoqëritë shqiptare të sigurimit kanë peshë jo të vogël në tregun kosovar. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis AMF-së dhe BQK-së ka ndikuar pozitivisht në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit, ekspertizës dhe përvojës midis dy institucioneve. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca e seminare rajonale mbi tema të tilla si “Perspektivat e Industrisë së Sigurimeve në dritën e zhvillimeve të ardhshme në kuadrin e integritimit në BE”, “Liberalizimi i produkteve të MTPL-së” të organizuara në Kosovë e Shqipëri.



Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë

Bashkëpunimi me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë** është konkretizuar me nënshkrimin gjatë këtij viti të Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje merr rëndësi në kushtet aktuale të shtrirjes dhe veprimit të kompanive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë. Ajo do të ndikojë pozitivisht në integritetin, stabilitetin dhe efikasitetin e industrisë së sigurimeve të të dy vendeve duke siguruar një strukturë bashkëpunimi përfshirë të gjitha kanalet e komunikimit, rritjen e mirëkuptimit reciprok dhe

shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave. Organizimi i seminarit mbi perspektiva të industrisë së sigurimeve në rajon, në Ohër, Maqedoni nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, ISA, shërbeu jo vetëm si një forum ku mbikëqyrës të tregut të sigurimeve në rajon ndanë eksperiencat më të mira të fushës por i shërbeu edhe forcimit të bashkëpunimit të vendeve të rajonit.

Konsolidimi i interesave Austriake në tregun Shqiptar të sigurimeve, si dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar midis AMF-së dhe **Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë** i ka hapur rrugën bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencës midis dy autoriteteve rregullatore. Në takimet e nivelit të lartë dhe teknik dy palësh është diskutuar për çështje që lidhen me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve të dy vendeve.



Ky bashkëpunim edhe këtë vit ka qenë shumë i suksesshëm, pasi dy rregullatorët janë angazhuar dhe kanë vendosur të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë eksperiencat në të mirën e të dy palëve, si dhe të takohen rregullisht e diskutojnë problemet e interesit dypalësh. Gjithashtu, gjatë vitit 2010, AMF ka pasur bashkëpunim edhe me organizma të tjerë që veprojnë në fushën e tregut të sigurimeve në Austri si **Shoqata e Sigurimeve të Austrisë, VVO**.

Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët

Në kuadrin e realizimit të projekteve strategjike të institucionit, si dhe rritjes së kapaciteteve institucionale, bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e suksesshme me donatorët vazhdojnë të luajnë një rol tepër të rëndësishëm në këtë drejtim.

Bashkëpunimi me **Bankën Botërore** ka qenë tepër i rëndësishëm në drejtim të kontributit të Bankës Botërore në projektet strategjike të AMF-së.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nën asistencën e Bankës Botërore dhe me financimin e First Initiative po punojnë për realizimin e Projektit “Për Mbikëqyrjen Efektive”. Puna e AMF -së dhe e ekspertëve të BB gjatë vitit 2010 vazhdoi me hartimin e manualit të integruar të mbikëqyrjes (off dhe on-site), i cili do të shërbeje si guidë në zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes, si dhe në përmirësimin e kuadrit ligjor në mbështetje të kësaj metodologjie. Këtij qëllimi i shërbeu edhe seminari i organizuar nga AMF në bashkëpunim me BB për prezantimin e projekt-metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun në sigurime, një përjasje kjo, që synon të identifikojë zonat me rrezik më të lartë në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe të ulë rrezikun në nivele të pranueshme, duke parandaluar kështu problemet financiare përpara se ato të ndodhin. Gjithashtu në kuadër të këtij projekti u realizua edhe një cikël trajnimesh me stafin e AMF-së.



Gjatë zhvillimit të takimit për mbikëqyrjen efektive

Nga ana e AMF-së janë bërë përpjekje për të përfutur mbështetjen e projekteve apo programeve të ofruara nga **Bashkimi Evropian**, si TAIEX (*Technical Assistance and Information Exchange*) i cili ofron asistencë teknike në fushën e përafrimit dhe zbatimit të legjislacionit komunitar, nëpërmjet organizimit të vizitave të ekspertëve evropianë në vend, organizimit të seminareve ose takimeve të ndryshme, si dhe organizimit të vizitave studimore në institucionet e vendeve të BE-së. Në kuadër të këtij projekti, u zhvillua seminari mbi zbatimin e direktivës së BE-së “Për marrjen në kontroll të shoqërive” që pati si qëllim prezantimin e Direktivës duke u fokusuar në drejtim të ofertave për marrjen në kontroll të shoqërive, rëndësinë e zbatimit

të saj, kompetencat e Autoritetit Rregullator, eksperiencat nga vendet e tjera që kanë zbatuar direktivën e lartpërmendur, si dhe rekomandimet në zbatimin e saj.

AMF ka mbajtur një bashkëpunim të ngushtë me **FSVC (Financial Services Volunteer Corps)** edhe gjatë vitit 2010. Konkretisht gjatë këtij viti është zhvilluar një program i gjerë trajnimesh të iniciuara nga AMF me mbështetjen e Financial Services Voluntary Corp, FSVC, në mbështetje të rritjes së njohurive të stafit të Autoritetit dhe pjesëmarrësve nga industria e sigurimeve. Ky Program u zhvillua në disa faza dhe i shërbeu pjesëmarrësve për rritjen e njohurive në lidhje me procesin e menaxhimit të riskut, rolin e menaxherëve të riskut në shoqëritë e sigurimit, etj. AMF vazhdoi edhe gjatë vitit 2010 mbështetjen e 3 punonjësve për ndjekjen e kursit të trajnimit në fushën e aktuaristikës, kurs i cili, organizohet nga FSVC dhe bazohet në praktikatat më të mira të Fakultetit dhe Institutit të Aktuarëve në Britaninë e Madhe.



Gjatë takimit për dorëzimin e sistemit të platformës së raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg

Bashkëpunimi me **Bankën Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH)** ka vazhduar të jetë i suksesshëm gjatë vitit 2010. Pas një pune intensive prej më shumë se një vjeçare, AMF instaloi në ambientet e saj platformën e re të raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg. Instalimi erdhi pas përfundimit me sukses të një projekti të përbashkët të AMF-së me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me financim nga Fondi i Ballkanit Perëndimor.

Synimi i platformës AMF In-Reg është informatizimi i procesit të raportimit të shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit në AMF. Ndërtimi i saj është realizuar nga AMF në bashkëpunim me shoqërinë konsulente të përzgjedhur, Vizor, Irlandë, me përvojë të veçantë në realizimin e platformave të ngjashme të mbikëqyrjes financiare në vende të zhvilluara.

Platforma garanton siguri dhe besueshmëri dhe rrit në të njëjtën kohë efektivitetin e procesit të raportimit prej shoqërive dhe të analizës të të dhënave nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2010, Autoriteti, bashkëpunoi dhe mbështeti iniciativën e **Ambasadës Italiane** dhe **Bursës së Italisë** për projektin **“Bursa shqiptare e letrave me vlerë”**. Faza e parë e projektit filloi me identifikimin e shoqërive shqiptare të gatshme dhe të përshtatshme për t'u listuar në segmentin AIM të Bursës së Italisë.

2.6 Integrimi Evropian

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është instrumenti evropian, i cili do të mundësojë



integrimin gradual të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke krijuar kuadrin e duhur për forcimin e shtetit ligjor dhe rritjen e efikasitetit të tij. Kjo marrëveshje parashikon adoptimin e *acquis communautaire* (tërësisë së rregullave dhe normave të BE-së) në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Qëllimi i përafrimit të legjislacionit është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun e brendshëm evropian dhe synimin parësor të përfitimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë.

Asociimi do të zbatohet në mënyrë progresive dhe realizohet plotësisht gjatë një periudhe tranzitore deri në dhjetë vjet, e ndarë në dy faza të njëpasnjëshme. Përafrimi i legjislacionit parashikohet të bëhet në dy faza 5-vjeçare, sipas një programi të detajuar, i cili përditësohet duke marrë parasysh realizimin e objektivave, si dhe vetë ndryshimet në të drejtën komunitare. Faza e parë fillon me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për AMF

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE, garantimin e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare jo-bankare, si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*acquis communautaire*) në këto fusha.

Neni 50 i MSA-së, parashikon që Shqipëria, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, t'u ofrojë shoqërive komunitare, si dhe degëve dhe filialeve të tyre një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u njihet kompanive, degëve apo filialeve shqiptare.

Neni 57 i marrëveshjes, parashikon që Shqipëria me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, angazhohet të lejojë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë komunitare, pa qenë nevoja për t'u vendosur.

Neni 70 i MSA-së parashikon detyrimin për të harmonizuar legjislacionin shqiptar në këtë fushë me *acquis* gjatë fazës së parë tranzitore.

Neni 89 i MSA-së parashikon që bashkëpunimi midis Palëve do të përqëndrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis communautaire* në sektorët e shërbimeve bankare, të sigurimit dhe financiare. Palët do të bashkëpunojnë me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e një kuadri të përshtatshëm për nxitjen e sektorëve të shërbimeve bankare, sigurimeve dhe financiare në Shqipëri.

Lidhur me monitorimin e zbatimit të MSA-së, organizohen raportime periodike nëpërmjet takimeve të përbashkëta Shqipëri-BE, sipas 7 nënkomiteteve.

AMF ka marrë pjesë rregullisht në takimet e përbashkëta Shqipëri-BE lidhur me monitorimin e zbatimit të MSA-së. AMF prezantoi zhvillimet më të fundit legjislative të tregut financiar jo-bankar dhe të kapaciteteve institucionale të tij në takimin për tregun e brendshëm dhe konkurrencën në takimin e 29 prillit 2010 të zhvilluar në Tiranë.

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (2009-2014).

AMF në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, 2009-2014, vijoi punën për nismat ligjore dhe veprimtaritë zbatuese që duhet të ndërmerren nga ana e saj. Kështu, gjatë vitit 2010, me miratimin e tre ligjeve:

- Ligji nr. 10 158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore;
- Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive";
- Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar".

vazhdoi puna për hartimin e akteve nënligjore për një përafrim sa më të plotë të Direktivave të BE-së, për fushat specifike të mbikëqyrura nga Autoriteti dhe për një respektim të të gjitha angazhimeve, të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Pyetëtori i KE-së

- Dorëzohet kërkesa për anëtarësim në BE - 28 prill 2009.
- Përfaqësuesi i BE-së, dorëzon Pyetëtorin e KE-së, mbi të cilin do të përgatitet opinionin e Komisionit Evropian në lidhje me aftësinë e Shqipërisë për të përmbushur kushtet e anëtarësimit në BE - 16 dhjetor 2009.
- Pyetëtori përmban 384 faqe, 2284 pyetje të ndara në 33 kapituj të acquis, të cilat prekin të gjithë segmentet e kuadrit ligjor evropian dhe kriteret e Kopenhagenit për anëtarësim.
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është pjesëmarrës aktiv duke dhënë kontributin e tij në më shumë se 10 kapituj.
- Në Kapitullin 9 "Shërbimet Financiare" Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF, është institucion koordinues i këtij kapitulli.
- Institucionet kontribuese për Kapitullin 9 janë AMF, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.
- Kapitulli 9 përmban 92 pyetje, nga të cilat 65 pyetje i përkasin AMF-së, 26 Bankës së Shqipërisë dhe 1 pyetje, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.
- Kapitulli 9 është i ndarë në katër pjesë: "Bankat dhe konglomeratet financiare", "Sigurimet dhe pensionet private", "Infrastruktura e tregut financiar", "Tregu i letrave me vlerë dhe shërbimet e investimeve".
- Pyetjet e këtij kapitulli përfshijnë rregullat për licencimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të kreditit, të shoqërive të sigurimit të jetës dhe Jo-Jetës, pensioneve private dhe fondeve të investimeve.
- Këshilli i Ministrave miraton përgjigjet përfundimtare të Pyetëtorit - 29 mars 2010.
- Dokumenti përfundimtar me përgjigjet e 2284 pyetjeve të Pyetëtorit përmban 3854 faqe.

Angazhimi i AMF-së në procesin e plotësimit të Pyetëtorit të KE-së.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (1 prill 2009) dhe dorëzimit të kërkesës për anëtarësim në BE (28 prill 2009), Qeveria Shqiptare duhet t'i përgjigjej sfidave të reja për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Procesi i përgjigjeve që institucionet shtetërore do t'i jepnin pyetjeve të Pyetëtorit të KE, do t'i shërbenin Komisionit Evropian për të vlerësuar se sa i përgatitur është shteti për të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE. Pyetëtori përcakton vijat e përgjithshme të zhvillimit të negociatave të mëtejshme për çdo kapitull të veçantë të acquis.

Në procesin e dhënies së përgjigjeve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka qenë në ndjekje të vazhdueshme të mirëmenaxhimit të këtij procesi, në përputhje me objektivin e përfundimit me sukses të tij. Për këtë Autoriteti ndërmoi një sërë hapash përgatitore, si ngritja e grupit të punës me përbërje punonjësit e këtij institucioni, trajnimi i tyre, si dhe nëpërmjet strukturës së tij menaxhuese



dhe koordinuese ka punuar për koordinimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi me institucione të tjera shtetërore të përfshirë në dhënien e përgjigjeve, për të shmangur çdo vonesë apo pasaktësi në dhënien e përgjigjeve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në vijim të Raportit Analitik të KE-së të muajit nëntor 2010, analizoi rekomandimet e bëra në këtë raport në lidhje me Kapitullin 9 “Shërbimet financiare”, si dhe ato të bëra në pjesën e “Kriterit ekonomik”. Për zbatimin e këtyre rekomandimeve AMF ka hartuar një plan veprimi ku përcaktohen objektivat e tij në drejtim të nismave ligjore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

Angazhime të tjera

- Në kuadrin e zbatimit të detyrimeve dhe angazhimeve që Republika e Shqipërisë ka ndaj **Organizatës Botërore të Tregtisë**, më 28-30 prill 2010, u zhvillua në Gjenevë takimi i këshillit të tregtisë së mallrave, i cili mori në shqyrtim raportin e politikave të tregtisë (Trade Policy Review) që prej anëtarësimit të Shqipërisë në OBT deri më sot. Ky ishte rishikimi i parë që bëhej pas anëtarësimit të Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë në vitin 2000.

Autoriteti ishte pjesë e delegacionit të Shqipërisë, i përbërë nga 15 anëtarë të institucioneve kontribuese për përgatitjen e raportit Trade Policy Review. Në raport u vu në dukje progresi i bërë nga momenti i anëtarësimit të Shqipërisë në OBT deri në vitin 2010, si dhe u dha një panoramë e përgjithshme e treguesve makroekonomike të vendit. Theksi u vendos në reformat e ndërmarra nga pala shqiptare për krijimin e një klime të favorshme për biznesin, për liberalizimin e tregjeve dhe zhvillimin e konkurrencës.

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadrin e raundit të katërt të vlerësimit të Shqipërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, u angazhua në procesin e dhënies së përgjigjeve të pyetësorit të përgatitur nga **Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës** për çështjet që lidhen me tregjet financiare jo-bankare. Në muajin nëntor 2010, u zhvilluan takime me ekipin vlerësues të këtij raundi, të përbërë nga ekspertë të FMN-së dhe Komitetit Moneyval të KE-së.

2.7 Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca

Rritja e cilësisë së informacionit dhe transparencës, komunikimit efektiv me publikun dhe edukimit financiar në përmbushje të rolit themelor: *Mbrojtjes së konsumatorit*, kanë qenë edhe gjatë vitit 2010 ndër prioritetet e punës së AMF-së. Një konsumator, i cili disponon njohuritë bazë dhe informacionin e duhur, është në gjendje të përzgjedhë produktin që i përgjigjet më mirë nevojave të tij.

AMF praktikon një sërë formash dhe mënyrash në përmbushjen e një komunikimi efektiv me publikun, ku mund të përmenden fletëpalosjet që përmbajnë informacion edukativ dhe statistikor të strukturuar, në lidhje me tregjet nën juridiksionin e AMF-së. Publikimet e ndryshme me karakter informativ dhe edukativ, kanë synuar njohjen e konsumatorëve me tregun financiar jo-bankar, mënyrën e funksionimit të tij, mbështetur dhe nga një faqe interneti e përditësuar, e cila e përmbush më së miri funksionin e saj në drejtim të komunikimit me të gjitha palët e interesit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet përditësimit të faqes zyrtare me informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin e AMF-së dhe Bordit, lajme dhe njoftime me karakter orientues dhe mbrojtës për publikun, materiale dhe informacione edukuese për produktet financiare jo-bankare dhe rëndësinë e tyre. Faqja zyrtare e AMF-së është e organizuar në dy gjuhë, Shqip dhe Anglisht, duke i dhënë mundësinë edhe përdoruesit të huaj të marrë informacionin e dëshiruar.

Botimet e AMF-së

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini Zyrtar
- Tregu i Sigurimeve - Raport Statistikor '99-'09

Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku i AMF-së
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private suplementare

Gjatë 2010, AMF ka qenë aktive në median e shkruar dhe elektronike, duke mbajtur një komunikim të vazhdueshëm në funksion të rritjes së transparencës për zhvillimet e fundit në tregjet financiare jo-bankare apo dhe për të qenë palë në dialogun mes grupeve të interesit për zhvillimin e këtyre tregjeve. Media e shkruar dhe elektronike ka shërbyer gjithashtu për të përcjellë mesazhin e AMF-së publikut, në funksion të fushatave sensibilizuese në drejtim të mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit.

Puna e vazhdueshme në drejtim të rritjes së cilësisë së informacionit, është konkretizuar në vitin 2010, me hartimin dhe publikimin e botimit të ri **Tregu**

i Sigurimeve - Raport Statistikor '99-'09. Në këtë publikim janë paraqitur të dhëna të detajuara në lidhje me primet e shkruara bruto, dëmet e paguara bruto, portofolin e investimeve, kapitalin e nënshkruar, provigjonet teknike, rezultatit teknik të ndarë sipas portofoleve, etj, të ndara këto edhe sipas llojit të sigurimeve Jetë dhe Jo-Jetë, si dhe për tregun në total. Për të pasur bazë krahasimi dhe për të dhënë tendencën e tregut të sigurimeve në vend janë përdorur të dhënat e viteve 1999 - 2009.



Publikime të AMF-së

Raportet periodike statistikore e financiare, që AMF publikon, japin një pamje të qartë të dinamikës së zhvillimit të tregjeve financiare jo-bankare dhe plotësojnë nevojat



për informacion me karakter tekniko-financiar, për një numër të gjerë përdoruesish. Këto raporte janë në dy gjuhë, përkatësisht Shqip dhe Anglisht, në mënyrë që dhe investitorët, apo analistët e huaj, të kenë një dritare informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri.

Qendra e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, u mundëson mbajtësve të mjeteve motorike, verifikimin e policave të sigurimit të detyrueshëm nëpërmjet rubrikës “Verifiko policën tënde”, në faqen zyrtare të AMF-së. Nëse polica e sigurimit nuk rezulton në sistem, konsumatori mund të depozitojë ankesë në rrugë elektronike.

Publikimi i projekteve ligjore në proces në faqen zyrtare të AMF-së para miratimit të tyre ka rezultuar një mënyrë efikase dhe transparente komunikimi në mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve të ndryshme nga të gjitha palët e interesit dhe publikut të gjerë. Viti 2010 është karakterizuar nga një sërë nismash të rëndësishme ligjore me ndikim të pritshëm në tregjet financiare jo-bankare, ku reagimi i palëve të interesit është vlerësuar si faktor tepër i rëndësishëm gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të projekteve.

AMF ka vijuar të informojë publikun nëpërmjet periodikut elektronik mujor, i cili përmban informacione të larmishme në lidhje me zhvillimet e sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri, si dhe me zhvillimet dhe tendencat globale më të fundit të rregullimit të tregjeve financiare jo-bankare. Periodiku përmban dhe një rubrikë të veçantë për edukimin e konsumatorit, ku kryesisht përfshihen punime mbi shërbimet dhe produktet financiare, të cilat janë nën juridiksionin e AMF-së. Po kështu një rubrikë i kushtohet dhe praktikave më të mira të përshatura nga tregjet e ndryshme dhe shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe komunikimit të reformave palëve të interesit apo dhe prezantimit të strategjive me ndikim të pritshëm në tregjet nën juridiksionin e AMF-së. Kryesisht mund të përmendet:

- Takimi i punës në bashkëpunim me Bankën Botërore, “**Drejt një mbikëqyrje efektive me fokus riskun në sigurime dhe përshtatja e kuadrit ligjor**”, ku u prezantua puna e bërë në bashkëpunim me First Initiative, mbi realizimin e Projektit “**Për Mbikëqyrjen Efektive**”, si draft-metodologjinë e re të mbikëqyrjes dhe përmirësimet e propozuara në kuadrin ligjor të fushës së sigurimeve. U prezantua puna e AMF-së dhe të ekspertëve të Bankës Botërore në drejtim të hartimit të manualit të integruar të mbikëqyrjes (on dhe off-site), i cili do të shërbejë si guidë në zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus riskun.



Gjatë zhvillimit të takimit për mbikëqyrjen efektive

- Takimi i punës në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda kuadrit të instrumentit TAIEX, **“Mbi zbatimin e direktivës “Për marrjen në kontroll të shoqërive”**”. Takimi pati si qëllim prezantimin e Direktivës së BE-së duke u fokusuar në drejtim të ofertave për marrjen në kontroll të shoqërive, rëndësinë e zbatimit të direktivës, kompetencat e Autoritetit Rregullator, eksperiencat nga vendet e tjera që kanë zbatuar direktivën e lartpërmendur, si dhe rekomandimet në zbatimin e saj. Gjatë takimit u vu theksi në rëndësinë e miratimit të Ligjit nr. 10236 datë 18.2.2010 “Për marrjen në kontroll të shoqërive publike”, risitë që sjell ky ligj, si dhe rolin e AMF-së dhe rregullatorëve të tjerë në mbikëqyrjen e procesit të marrjes në kontroll.
- Instalimi në ambientet e AMF-së i **platformës së re të raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg**. Instalimi erdhi pas përfundimit me sukses të fazës së katërt të një projekti të përbashkët të AMF-së me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me financim nga Fondi i Ballkanit Perëndimor. Synimi i platformës AMF In-Reg është informatizimi i procesit të raportimit të shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit në AMF. Ndërtimi i saj është realizuar nga AMF në bashkëpunim me shoqërinë konsulente të përzgjedhur, Vizor, Irlandë, me përvojë të veçantë në realizimin e platformave të ngjashme të mbikëqyrjes financiare në vende të tjera si: Mbretëri e Bashkuar, Irlandë, Slloveni, etj. Platforma garanton siguri dhe besueshmëri dhe rrit në të njëjtën kohë efektivitetin e procesit të raportimit prej shoqërive dhe të analizës së të dhënave nga autoriteti.

Kapitulli 3

Mbrojtja e Konsumatorit



Mbrojtja konsumatore një nga prioritetet strategjike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Parimet e IAIS për ushtrimin e aktivitetit siguries ne lidhje me mbrojtjen konsumatore:

Parimi 4: Transparenca e Informacionit ndaj Konsumatorit

Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit duhet t'i kushtojnë kujdesin e duhur informacionit të nevojshëm për konsumatorët e tyre, si dhe t'i trajtojnë ata në mënyrë të drejtë.

Parimi 7: Marrëdhënia me Rregullatorin

Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit duhet të sillen me rregullatorët e tyre në mënyrë të hapur dhe bashkëpunuese.

Parimi 8: Ankimimi

Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit duhet të mbështesin një sistem për trajtimin e ankimeve në rast që ato janë të aplikueshme.

Konsumatori, nën juridiksionin e AMF-së, është i siguruari, investitori dhe kontribuesi në skemat vullnetare të pensioneve.

Gjatë vitit 2010, AMF, me qëllim mbrojtjen konsumatore, është përpjekur të përqendrohet në inkurajimin e ofruesve të shërbimeve financiare jo-bankare dhe informimin e konsumatorit. Përpjekjet për inkurajimin e ofruesve të shërbimeve përfshijnë:

- trajtimin e ankesave të konsumatorit;
- thellimin e hetimit, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorit;
- sanksionet për moszbatim të ligjit;
- nxitjen e subjekteve për të promovuar zbatimin e praktikave të shëndosha;
- mbështetjen në vetërregullimin e subjekteve të mbikëqyrura.

Autoriteti, në zbatim të Ligjit nr. 10076, datë 29.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", ka analizuar në mënyrë të hollësishme kontratat e reja që parashikon ky ligj. Gjithashtu, janë analizuar kushtet e përgjithshme të disa kontratave të reja të sigurimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Komunikimi dhe transparenca ndaj publikut

Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij në lidhje me komunikimin dhe transparencën ndaj publikut, janë në përputhje me kërkesat e Direktivave 2002/83/EC dhe 92/49/EEC.

Komunikimi dhe transparenca ndaj publikut përbën dhe një nga mjetet në funksion të mbrojtjes konsumatore.

Objektivi i këtij përcaktimi është që konsumatori të informohet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që ai të jetë në gjendje të përzgjedhë dhe të vlerësojë situatën që i paraqitet.

Në lidhje me këtë, Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe aktet e tjera nënligjore, detyrojnë shoqëritë e sigurimit t'i ofrojnë konsumatorit informacionin e përditësuar, në lidhje me produktet e sigurimit, kushtet e kontratës, me zgjidhjen e plotë dhe të pjesshme të kontratës, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, primet, etj.

AMF, në mënyrë të vazhdueshme, informon konsumatorin (nëpërmjet medias vizive dhe të shkruar), si dhe nëpërmjet faqes së internetit e organizuar në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht, me informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin e tij, lajme dhe njoftime me karakter orientues dhe mbrojtës për publikun.

AMF praktikon një sërë formash dhe mënyrash për një komunikim efektiv dhe transparencë me publikun si p.sh marrje pjesë në emisione televizive, fletëpalosje që përmbajnë informacion të bollshëm edukativ dhe statistikor për tregjet nën juridiksionin e tij.

Procedura e ankesave

Gjithë hallkat e strukturës organizative të AMF-së, drejtpërsëdrejti ose indirekt, janë në funksion të mbrojtjes së konsumatorit. Përveç kësaj, funksionon dhe një strukturë e veçantë siç është njësia e mbrojtjes konsumatore, e cila vepron për mbrojtjen konsumatore:

- në tregun e sigurimeve;
- në tregun e letrave me vlerë;
- në fondet e pensioneve private vullnetare.

Pranë kësaj njësie çdo person mund të drejtohet për të kërkuar sqarime në lidhje me kontratat e sigurimit, kontratat e fondeve private vullnetare të pensioneve, sugjerime apo për të paraqitur një ankesë, si për kontratat e sigurimit, ashtu dhe për mundësimin e dëmshpërblimit të shkaktuar nga bankat e nivelit të dytë.


Njësia për mbrojtjen konsumatore, gjatë vitit 2010, ka shqyrtuar rreth 62 ankesa në lidhje me dëmshpërblimin që rrjedh nga kontratat e sigurimit dhe afatet e trajtimit apo rastet e refuzimit.

Ligji nr. 10 076, datë 12.02.2009 "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit" dhe Rregullorja nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata



e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", kanë ndikuar në rënien e numrit të ankesave në krahasim me vitin 2009. Këto akte ligjore dhe nënligjore kanë rritur ndjeshëm masën e dëmshpërblimit, si dhe kanë zvogëluar afatet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, për dëmet që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

Grafiku i ankesave dhe zgjidhjet 2007-2010



Shërbimi i konsumatorit

Sistemi telefonik në mbrojtje të konsumatorit, përfshin numrin fiks si dhe numrin jeshil, ku bëhet i mundur aksesimi i shërbimeve pa pagesë nga ana e konsumatorëve.

Gjatë vitit 2010, ky shërbim, nëpërmjet linjës telefonike ka pasur një rritje të ndjeshme të telefonatave. Sistemi ka trajtuar mbi 600 telefonata në mënyrë automatike dhe mbi 100 çështje nëpërmjet bashkëpunimit me specialistët e Drejtorisë së Zbatueshmërisë dhe sektorëve të tjerë të Autoritetit.

Nëpërmjet këtij shërbimi konsumatori ka bërë pyetje kryesisht për produktet e ofruara nga shoqëritë e sigurimit apo ka paraqitur një ankesë në lidhje me ofrimin e këtyre produkteve.

Njësia për mbrojtjen konsumatore ka shqyrtuar sipas problematikave me seriozitet mesazhet zanore, si dhe sipas rasteve ka bërë të mundur dërgimin e tyre për shqyrtim në sektorët përkatës.

PJESA II TREGJET E MBIKËQYRURA


II.1 Tregu i sigurimeve

Vështrim i përgjithshëm

Tregu i sigurimeve vazhdon të njohë rritje edhe gjatë vitit 2010, ku vijuan të ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhjetë shoqëri sigurimi, nga të cilat gjashtë shoqëri të sigurimit të Jo-Jetës, dy shoqëri të sigurimit të Jetës, një shoqëri kompozite e Jetës dhe Jo-Jetës dhe një shoqëri e Jo-Jetës dhe shoqëri Risigurimi.

Zhvillimi i tregut të sigurimeve në vite

(në mln lekë)



Në vitin 2010 primet e shkruara bruto kapën shifrën 8.2 miliardë lekë, ose rreth 4.18% më shumë se shifra përkatëse e vitit 2009. Rritja e primeve në vitin 2010, është më e ulët, krahasuar me rritjen në vitet paraardhëse (11.32%, 18.97% dhe 30.97% përkatësisht 2009, 2008 dhe 2007). Rreth 7.3 miliardë lekë ose 88.99% e totalit të volumit të primeve të tregut i takojnë sigurimeve të Jo-Jetës, 0.8 miliardë lekë ose 10.34% e totalit të tregut i takon sigurimeve të Jetës, ndërsa 0.1 miliardë lekë ose 0.67% e totalit të tregut i takon primeve nga aktiviteti i risigurimeve.


Viti 2010 vazhdoi të zbusë raportin e strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 48.30% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 51.70% të tregut.



Tabelë 11: Primet e shkruara bruto 2010

Lloji i sigurimit	Numri i kontratave	Primet e Shkruara Bruto	
		(në mln lekë)	(konvertuar në mijë euro)
A Sigurime të detyrueshme	412,364	4,243	30,790
B Sigurime vullnetare	323,914	3,964	28,770
B1 Sigurimi i jetës	69,915	848	6,157
B2 Sigurimi i jo-jetës	253,999	3,061	22,212
B3 Veprimtari Risigurimi		55	401
GJITHSEJ	736,278	8,207	59,560

Struktura e tregut të sigurimeve 2010




Sigurimet e detyrueshme

Gjatë vitit 2010, sigurimet e detyrueshme motorike (të përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorike ndaj palëve të treta) vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë rreth 51.70% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit MTPL e brendshme, në vitin 2010, arritën në rreth 2.9 miliardë lekë, ose rreth 7.10% më shumë se në vitin 2009.

Në vitin 2010, primet e shkruara bruto të portofolit Kartoni Jeshil ishin rreth 0.9 miliardë lekë, ose rreth 14.42% më pak se në vitin 2009. Ky produkt tregtohet në bazë të tarifave fikse, të cilat janë të detyrueshme për operatorët në treg.

Zhvillimi i sigurimeve të detyrueshme në vite




Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë vitit 2010 arritën në rreth 0.4 miliardë lekë, apo rreth 1.91% më shumë se në vitin 2009.

Sigurimet vullnetare

Në vitin 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në rreth 4 miliardë lekë, ose 7.54% më shumë se të ardhurat e një viti më parë. Kjo rritje ndjehet si në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës po ashtu dhe në sigurimet e Jetës.

Zhvillimi i sigurimeve vullnetare të Jo-Jetës në vite



Shënim: 1) Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës janë përfshirë dhe primet nga veprimtaria e Risigurimit




Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës me të ardhura rreth 3 miliardë lekë, vendin e parë e zunë zjarri dhe dëmtimet në pronë me rreth 34.96%, të pasuara nga sigurimi kasko me rreth 19.52%, sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me rreth 16.44% të të ardhurave të këtij grupi dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në 2010 arritën në rreth 457 milionë e shëndetit me rreth 70.87% të të ardhurave të këtij grupi.

Futja e investitorëve të huaj në treg këto vitet e fundit, ka patur ndikimet e veta në drejtim të prezantimit të një game të re produktesh vullnetare, të cilat kanë gjetur hapësirat e duhura në treg, si sigurimi i shëndetit privat, ndërkohë liberalizimi i vizave dha ndikimet e veta në rritjen e volumit të primeve të shkruara dhe kontratave të sigurimit të shëndetit në udhëtim.

Primet e shkruara bruto të Jo-Jetës në periudhën 2007-2010



Primet në sigurimet e Jetës në vitin 2010 arritën në rreth 848 milionë lekë, ose rreth 17.61% më të larta se në vitin 2009. Sigurimi i Jetës vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies, kryesisht për individët. Ky fakt mbështetet dhe me analizimin e produkteve, që patën ndikimin kryesor në rritjen e këtij tregu. Kështu, 66.37% e rritjes ka ardhur nga portofoli “Jetë Debitori”, ku përfitues janë bankat e nivelit të dytë, të cilat i akordojnë kredi individëve dhe rreth 17.49% e rritjes vjen nga portofoli “Sigurime që lidhen me fonde investimi”. Rritja e primeve të shkruara bruto në portofolin e sigurimit “Jetë Debitori” është 18.06% më shumë se në vitin 2009, e shoqëruar kjo dhe me një rritje të numrit të kontratave në masën 7.78%.


Dëmet

Gjatë vitit 2010 shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 2.29 miliardë lekë dëme, ose rreth 32.04% më shumë se në 2009, ndërsa rritja e primeve të shkruara bruto ishte 4.18% krahasuar me një vit më parë. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve të detyrueshme motorike me 1.46 miliardë lekë, apo 63.85% të totalit. Pavarësisht rritjes në vlerë absolute të dëmeve të paguara bruto, raporti i ulët dëme/prime tregon se tregu ka ende shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj klientit e publikut në tërësi.

Shpërndarja gjeografike e sigurimeve


Duke i hedhur një vështrim primit të shkruar bruto sipas shpërndarjes gjeografike, të bie në sy një përqëndrim i tregut të sigurimeve në Prefekturat e mëdha.

Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është primi për frymë, i cili për vitin 2010 është rreth 2,552 lekë për frymë, me një rritje prej 108 lekë për frymë, krahasuar me një vit më parë. Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura e Tiranës me 6,231 lekë për frymë zë vendin e parë e pasuar nga prefektura e Gjirokastrës me 3,275 lekë për frymë dhe më tej ajo e Durrësit dhe e Korçës, përkatësisht me 2,070 lekë për frymë dhe 1,642 lekë për frymë.




Shpërndarja e primeve të sigurimit sipas prefekturave

Dëmet e paguara sipas prefekturave






Struktura e dëmeve të paguara 2010



Pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit në vite


(në mln lekë)



Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2010, tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës u nda ndërmjet kompanive të sigurimeve: Sigal Uniqa Group Austria, Sigma Vienna Insurance Group, Insig, Atlantik, Interlbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosigg.

Sigal Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 30.72% të primeve të shkruara bruto.



Gjatë vitit 2010, aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life Uniqa Group Austria, Insig dhe Sicred. Sigal-Life Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me rreth 52.23% të primeve të shkruara bruto.

Risigurimet

Rreziqet e kontraktuara dhe mbulimi me risigurim

Gjatë vitit 2010 shoqëritë e sigurimit kanë kontraktuar rreziqe, të cilat i përkasin si sigurimit të pasurive të ndryshme, sigurimit të bankave, sigurimit të marinës e aviacionit, sigurimit të Jetës, ashtu edhe sigurimit të përgjegjësive, siç është rasti i ndërtimit të rrugëve të ndryshme gjatë gjithë territorit të vendit, apo sigurimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta të drejtuesve të automjeteve si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në vendet e tjera anëtare të sistemit të Kartonit Jeshil.

Lidhur me këto rreziqe, Autoriteti ka monitoruar mënyrën e administrimit dhe transferimit të rrezikut prej shoqërive të sigurimit, si nëpërmjet kontrollit mbi dokumenta edhe nëpërmjet kontrollit pranë kompanive të sigurimit. Kompanitë përdorin kapitalet e nevojshme dhe kryejnë diversifikimin e portofoleve të sigurimit, si nëpërmjet bashkësigurimit, nëpërmjet kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit në tërësi dhe mbulimin me risigurim fakultativ në kontrata të veçanta, në funksion të rritjes së kapacitetit të tyre dhe zbutjes së efekteve financiare prej dëmeve të mëdha.

Marrëveshjet risiguroese në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë si të formës jo proporcionale të tipit Excess of Loss, ashtu edhe të formës proporcionale të tipit Quota Share e Surplus.

Ndërkohë, në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguroese të formës proporcionale të tipit Surplus e të tipit Quota Share.



AMF ka monitoruar marrëveshjet risiguruese dhe kontratat fakultative të risigurimit në përputhje me kërkesat ligjore të mbajtjes maksimale për rrezik dhe kritereve të lidhura me cilësinë e risiguruesve. Primet e ceduara në risigurim për vitin 2010 rezultojnë 1,191,656,835 lekë ose 14.5% e primeve të shkruara bruto.

Partnerët risigurues të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BBB- Standard & Poors, nga ku mbi 38% kanë klasifikim më të lartë se A. Ndër pjesëmarrësit kryesorë në këto programe risigurimi mund të përmendim Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Scor, Lloyd's Syndicates, etj.

Krijimi dhe mbajtja e përshtatshme e provigjoneve teknike e matematike të sigurimit

Një pikë shumë e rëndësishme për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes financiare të shoqërive të sigurimit janë analizat periodike lidhur me mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike e matematike. Lidhur me këtë, AMF ka monitoruar me kujdes përlllogaritjet e provigjoneve teknike e matematike në çdo tremujor, bazuar në ligjin e sigurimeve dhe rregulloret përkatëse, duke kryer dhe takime të përbashkëta me aktuarët e shoqërive të sigurimit për metodat më të mira të përdorshme lidhur me përlllogaritjen e tyre.

Komiteti i Aktuarëve

Bazuar në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Rregullores nr. 75 date 28.08.2009 “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, Komiteti i Aktuarëve, si grup konsultativ, propozon tarifën e primeve të sigurimit të detyrueshëm.

Komiteti i Aktuarëve është i përbërë nga 9 anëtarë, një përfaqësues nga çdo shoqëri sigurimi dhe një përfaqësues nga AMF. Analiza aktuariale e tarifave të sigurimit MTPL bazohet kryesisht në eksperiencën e dëmeve të ndodhura në periudha të mëparshme, si dhe në supozimet për të ardhmen. Komiteti i Aktuarëve llogarit primin e rrezikut mbi bazën e të dhënave statistikore të tregut në vite. Primi i sigurimit llogaritet si shumë e primit të rrezikut me ngarkesën mbi primin e rrezikut. Në zbatim të nenit 8, pika 4, të Rregullores nr. 75 datë 28.08.2009 “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” niveli i ngarkesës mbi primin e rrezikut nuk duhet të kalojë masën 25% të primit të sigurimit.

II.2 Tregu i letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), është i vetmi treg aktiv në tregun e letrave me vlerë në Shqipëri, ndërsa tregu i aksioneve vazhdon të

mbetet ende i pazhvilluar. Platforma GSRM (Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë) mundëson informacion të përditësuar me bazë ditore, në lidhje me transaksionet, kuotimet, çmimet dhe rezultatet, në lidhje me këto letra me vlerë. Të gjithë ndërmjetësit financiarë, të licencuar për të operuar në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, janë të detyruar të publikojnë të gjithë informacionin e mësipërm nëpërmjet platformës GSRM.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Tregu sekondar (transaksionet e llojit B dhe C) i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2010 u dominua në masën 87.18% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 12.82% nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 98.73% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Transaksionet "Shlyerje e vlerës nominale në maturim" dhe "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar" dominojnë tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2010, përkatësisht në masën 46.39% dhe 24.74% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 96.66% të të gjitha transaksioneve në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominojnë këtë treg në raport me personat juridikë.

Tabelë 12: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
Letra me Vlerë të Qeverisë		2009	2010	'10 / '09-1
A	Blerje në tregun primar	8,601	9,321	8.37
	Individë	6,724	5,938	(11.69)
	Persona juridikë	1,877	3,383	80.22
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	20,367	11,643	(42.84)
	Individë	8,196	7,278	(11.20)
	Persona juridikë	12,171	4,364	(64.14)
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit	2,951	4,192	42.09
	Individë	1,053	2,747	161.03
	Persona juridikë	1,898	1,445	(23.87)
D	Vendosje e bonove si kolateral	83	72	(13.24)
	Individë	68	60	(11.68)
	Persona juridikë	15	12	(20.47)
E	Shlyerje e vlerës nominale në maturim	15,150	21,828	44.07
	Individë	8,989	13,703	52.45
	Persona juridikë	6,162	8,125	31.86

Platforma GSRM (Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë)

Platforma GSRM tashmë ka katër vite që është projektuar, ndërtuar dhe menaxhuar nga AMF, me qëllim që të sigurojë rritje të transparencës në lidhje me kuotimet dhe transaksionet



në tregun me pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve. Ky objektivi është realizuar me sukses, pasi platforma tashmë funksionon normalisht dhe një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe ndërgjegjësimi i lartë i subjekteve të licencuara nga AMF për të operuar në këtë treg, në lidhje me përfitimet nga transparenca dhe publikimi në kohë reale i të dhënave mbi kuotimet dhe transaksionet e ekzekutuara çdo ditë.

Me emetimin e eurobonove nëntëmujore domosdoshmërisht lindi nevoja e zbatimit të saj në platformën e GSRM-së, në mënyrë që të jetë në një vijë dhe në kohë reale me transaksionet që emetohen. Subjektet të licencuar nga AMF për ushtrimin e tregtimit të letrave me vlerë të Qeverisë, krahas tregtimit të transaksioneve të ndryshme në lekë pasqyrojnë në tregun me pakicë edhe eurobonon nëntëmujore.

Platforma GSRM është kthyer në një nga rubrikat me interes më të lartë nga vizitorët e shumtë të faqes zyrtare të internetit të AMF-së, duke zënë rreth 14% të gjithë vizitave. Interesi i publikut për platformën GSRM vjen në rritje, gjë që vihet re në numrin e vizitorëve vendas dhe ndërkombëtarë gjatë vitit 2010.

Platforma GSRM jep një informacion të plotë dhe të përditësuar për publikun dhe investitorët institucionale në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë. Në këtë platformë, përfshihet dhe një bazë e të dhënave historike, e cila i vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna dhe për qëllime statistikore apo akademike.

Kjo rubrikë do të vijojë të përmirësohet me elementë të rinj, në mënyrë që t'i shërbejë sa më mirë objektivit të saj, që është transparenca, aksesimi dhe përpunimi nga publiku në kohë reale i informacionit nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të AMF-së.

Tregu i kapitaleve

Tregu i aksioneve mbetet ende i pazhvilluar. Edhe viti 2010 nuk shënoi ndonjë ngjarje të re për zhvillimin e aktivitetit në Bursë. Listimi i shoqërive dhe tregtimi i aksioneve në Bursë mbetet një përpjekje potenciale. Pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme të Bursës së Tiranës për të afruar biznesin vendas, faktorë të shumtë, si madhësia e bizneseve (kryesisht biznes i vogël dhe i mesëm), mënyra e funksionimit të biznesit, trashëgimia kulturore dhe mentaliteti, kriza financiare ndërkombëtare, kanë ndikuar në moszhvillimin e tregut të kapitalit. Nga ana tjetër, interesimi i subjekteve të huaja për zhvillimin e aktivitetit të Bursës, apo për zhvillimin e aktivitetit të ndërmjetësimit, janë tregues optimistë për zhvillimin e tregut të kapitalit.

Në mungesë të një tregu të organizuar, aksionet vazhdojnë të tregtohen mes aksionarëve duke regjistruar ndryshimin e pronësisë në regjistrat e shoqërive aksionare. Nga ana tjetër

shoqëritë e dala nga privatizimi dhe të regjistruara në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, transaksionet mes aksionarëve i regjistrojnë pranë kësaj qendre. Tendenca, e vërejtur në vitet e fundit, është ajo e konsolidimit të pronësisë në shoqëritë e privatizuara, dhe kjo ka rezultuar në uljen e numrit të transaksioneve në aksione për këto shoqëri nga viti në vit. Gjithashtu, edhe shoqëri të tjera aksionare, përfshirë shoqëritë e sigurimit dhe disa banka mbajnë regjistrin e aksioneve të tyre pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.

“Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” është shoqëri aksionare, që zotërohet në masën 85% nga shteti shqiptar. Kjo shoqëri është licencuar nga AMF si regjistër i aksioneve. Përveç regjistrimit të pronësisë së kompanive në formë elektronike (Book-Entry), QRA ofron edhe shërbime të tjera për shoqëritë e regjistruara. Në fund të vitit 2010, QRA numëron 62 shoqëri aksionare të regjistruara.

Tabelë 13: Statistika mbi transaksionet e regjistruara në QRA për vitin 2010

<i>Nr. Klasifikimi</i>	<i>Statistika</i>
1. Nr. Total i shoqërive aksionare të regjistruara pranë QRA-së	62
2. Nr. Total i aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së	420 931 118
3. Nr. Total i shoqërive aksionet e të cilave janë tregtuar	28
4. Nr. Total i transaksioneve të ekzekutuara gjatë vitit 2010	602
5. Nr. Total i aksioneve të tregtuara gjatë vitit 2010	603 062 390
6. Përqindja e transaksioneve të tregtuara gjatë vitit 2010	143%

Burimi: Qendra e Regjistrimit të Aksioneve

Gjatë vitit 2010, QRA ka reflektuar në regjistrat e aksioneve të shoqërive aksionare 602 transaksione, krahasuar me 369 transaksione të kryera në vitin 2009. Numri i aksioneve të tregtuara jashtë tregut të organizuar gjatë vitit 2010, përbën rreth 143% të të gjithë aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së, ç’ka tregon se volumi i transaksioneve është rritur.

II.3 Tregu i pensioneve private vullnetare

Zhvillimi i tregut të pensioneve private vullnetare

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, porë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për vitin 2010, shihet një rritje prej 53.38% e kontributeve dhe një rritje prej afër 12.71% e numrit të kontribuesve, krahasuar me vitin 2009.

Hyrja në fuqi e Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”, ka sjellë përmirësimin e bazës ligjore dhe miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji. Ky ligj bëri të mundur përshtatjen me standardet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane për kolonën e tretë të fondeve private të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara.



Ligji ka për qëllim përmirësimin e sistemit ekzistues të pensioneve vullnetare private në Shqipëri me ndikime të pritshme:

- lehtësim në planin afatgjatë të kostove sociale duke stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre;
- shtimin e nivelit të kursimit të popullatës dhe rritjen e investimeve afatgjata në vend.

Më poshtë pasqyrohen disa të dhëna mbi tregun e pensioneve vullnetare private:

Tabelë 14: Tregu i Pensioneve Private Vullnetare viti 2009, 2010 (kontribute)

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Viti			'10 / '09 -1		
Raiffeisen PENSIONS	39,420,560	50,434,238	27.94	54.02	45.06
Capital IPP	19,522,151	45,065,548	130.84	26.75	40.27
Sigma IPP	14,025,862	16,420,362	17.07	19.22	14.67
TOTAL	72,968,573	111,920,148	53.38	100.00	100.00

Tabelë 15: Tregu i Pensioneve Private Vullnetare viti 2009, 2010 (kontribues)

Shoqëria	Numri i Kontribuesve		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Viti			'10 / '09 -1		
Raiffeisen PENSIONS	1,679	1,786	6.37	37.91	35.78
Capital IPP	1,774	2,191	23.51	40.05	43.89
Sigma IPP	976	1,015	4.00	22.04	20.33
TOTAL	4,429	4,992	12.71	100.00	100.00

Objektivat e zhvillimit të sektorit financiar jo-bankar

Përafrimi i legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Evropian, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, strukturimi i zhvillimit të tregjeve sipas standardeve dhe mbrojtja e konsumatorit, mbeten objektivat kryesorë, që përbëjnë dhe fokusin e punës së AMF-së në të ardhmen.

Fokusi dhe energjitë e një pune tre vjeçare, priten të finalizohen në vitin 2011, duke bërë të mundur futjen gradualisht të metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun, si një mbikëqyrje efektive në sigurime.

Mbikëqyrja me fokus riskun, si një metodologji e re që ndjek standardet ndërkombëtare pritet të konkretizohet në dy dokumente kryesore, përveç hartimit të Manualit të Mbikëqyrjes me Fokus Riskun:

- Draft-Ligji i ri i Veprimtarisë së Sigurive dhe Risigurimeve së bashku me aktet nënligjore që rrjedhin prej tij;
- Strategjia e zbatimit të Manualit të Mbikëqyrjes me Fokus Riskun.

së bashku me aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre.

Hartimi i Manualit të Mbikëqyrjes dhe Draft-Ligji i ri i Veprimtarisë së Sigurimeve dhe Risigurimeve ka kërkuar një punë dhe energji nga stafi i Autoritetit krahas detyrave të tjera.

Fokusi i Autoritetit për vitin 2011, vazhdon të mbetet dhe forcimi i kapaciteteve institucionale. Kjo ka sjellë dhe nevojën për ndryshime në Ligjin "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", për të siguruar të gjithë elementet e nevojshëm të pavarësisë, për ushtrimin e aktivitetit të një institucioni mbikëqyrës financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe motivimin e personelit të kualifikuar në këtë fushë.

Nismat dhe ndryshimet ligjore të viteve të fundit, në të tre tregjet nën juridiksionin e AMF-së, përbëjnë hapa cilësorë në drejtim të përafrimit të standardeve rregullative me ato të Bashkimit Evropian, hapësirave për zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve financiare jo-bankare, si dhe në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Përmirësimi i raportimit dhe futja në zbatim e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, shënon një hap të rëndësishëm drejt rritjes së cilësisë së raportimit dhe përpunimit të informacionit, duke rritur për rrjedhojë cilësinë e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe pensioneve private vullnetare.

Reformat ligjore, përmirësimi i standardeve dhe rritja e cilësisë së mbikëqyrjes pritet të kenë ndikim pozitiv në rritjen e interesit të investitorëve të huaj prestigjiozë për tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri.

Tendencat globale të largimit nga mbikëqyrja tradicionale drejt asaj me fokus risku, janë përkrahur nga AMF dhe janë përkthyer në një punë intensive me mbështetjen e Bankës Botërore, për të kaluar në një mbikëqyrje më efektive të tregut të sigurimeve në Shqipëri, në fokus të së cilës do të jetë risku dhe për rrjedhojë përdorimi më efikas i burimeve të kufizuara.


Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit është një element kyç në përmbushjen e funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës të AMF-së. Forcimi i mëtejshëm dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucione brenda dhe jashtë vendit, do të jenë në fokusin e vazhdueshëm të AMF-së për periudhat në vijim.

Fushatat edukuese dhe nxitëse për publikun, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare, në linjë me rritjen e cilësisë së instrumentave për mbrojtjen e konsumatorit, kanë qenë dhe do të vijojnë të jenë objektiva strategjike të AMF-së, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve financiare jo-bankare.

Të gjithë këto zhvillime cilësore, i hapin rrugën sfidave përherë e më të mëdha, që karakterizojnë një treg dinamik e në zhvillim si Shqipëria, sfida të cilat përballohen me strategji të qarta, staf të kualifikuar dhe komunikim proaktiv me aktorët e tregut.

SHTOJCA A

Struktura e AMF



SHTOJCA B

Kuadri ligjor/rregullativ në sektorin financiar jo-bankar

Në Fushën e Sigurimeve

Referenca Ligjore/Rregullative	Emërtimi	Përshkrimi i Ligjit/Rregullores
Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004	Për veprimtarinë e sigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime	Objekt i këtij ligji është vendosja e parimeve dhe rregulleve të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.
Ligji nr. 10 076, datë 12.02.2009	Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit	Oëllim i këtij ligji është përmirësimi i bazës ligjore të sigurimit të detyrueshëm. Ky zhvillim ligjor ndërmerr të një kohë kur tregu i sigurimeve ka avancuar me shpejtësi dhe kërkohen ndryshime ligjore në përgjigje të këtij zhvillimi, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe përafritim me standardet ndërkombëtare.
VKM nr. 191, datë 25.03.2005	Për miratimin e metodikës mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe Jo-Jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë	Në vendim përcaktohet mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe Jo-Jetës të shoqërive të sigurimit si dhe elementët që e përbëjnë atë.
VKM nr. 5, datë 07.01.2009 propozuar me vendim Bordi nr. 166, datë 23.12.2008	Për disa ndryshime në Vendimin nr. 96, datë 03.08.2008 të Këshillit të Ministrave "Për aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimeve	Ndryshimet në VKM nr. 96, datë 03.08.2008, kanë për qëllim rritjen e kufirit të sipërm të lejueshëm për investimin e provigjoneve teknike e matematike në toka dhe ndërtime, i cili do të jetë në masën 30 përqind, nisur dhe nga mundësitë e kufizuara të investimit brenda vendit.
VKM nr. 96, datë 03.02.2008, propozuar me vendim Bordi nr. 3, datë 18.06.2007	Për aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit	VKM përcakton mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike si pjesën më të rëndësishme të përgjegjësi të një shoqërie sigurimi, duke përfaqësuar detyrimet e tyre që lidhen drejtpërdrejt me kontratat e sigurimit.
VKM nr. 79, datë 28.01.2008 propozuar me vendim Bordi nr. 4, datë 30.08.2007	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime, si dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës	VKM përcakton kriteret dhe procedurat për licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së brokerimit në sigurime dhe në kriteret për licencimin e aktivitetit të agjentit në sigurime.
VKM nr. 164, datë 28.01.2008, propozuar me vendim Bordi nr. 3, datë 30.08.2007	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime	VKM parashikon dispozita të përgjithshme ku krahas karakteristikave të licencës përcaktohen kufizime lidhur me aktivitetet e tjera dëmtuese që mund të ushtrohen me natyrën e profesionit të tij.
Udhëzimin nr. 10, datë 08.02.2007	Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit	Udhëzimi përcakton listën e dokumenteve që përbëjnë llogaridhënien e detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit, të cilat paraqiten në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Udhëzim nr. 11, datë 08.02.2007	Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatore	Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për publikimin e të dhënave të nevojshme për të bërë të mundur njohjen nga publiku të gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit dhe për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë së sigurimit për pagimin e dëmshpërblimeve dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera, si dhe përcaktimi i rregullave për dhënie të informacionit konsumatorit përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, ose gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.
Udhëzim nr. 12, datë 08.02.2007	Për përcaktimin e kriterëve të shoqërive të risigurimit me të cilat shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë mund të lidhin marrëveshje risigurimi	Ky udhëzim ka si objekt rregullimin e veprimtarisë risigurorese të shoqërive të sigurimit, që mund të risigurojë pjesë të përgjeshme që ka kontraktuar me të siguruarit, me shoqëritë risigurorese vendase, degë të shoqërive risigurorese të huaja të licencuara nga Autoriteti i Mbrojtjes Financiare ose shoqëri risigurorese të huaja që plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë udhëzim.
Udhëzim nr. 15, datë 22.02.2008, propozuar me vendim Bordi nr15, datë 22.02.2008	Për përmbajtjen e raportit të auditit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabel të autorizuar	Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i elementëve të domosdoshëm që duhet të përmbajë raporti i auditimit mbi shoqëritë të sigurimit, hartuar nga shoqëritë e ekspertëve kontabel të autorizuar.
Udhëzim nr. 6, datë 30.08.2008	Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime	Ky udhëzues përcakton parimet e mbrojtjes së policëmbajtësve, përfutuesve apo palëve të treta. Në të njëjtën kohë dhe për shoqëritë e sigurimit përbën një element kyç në konkurrencën mes ofruesve të sigurimit dhe përmirësimin të imazhit publik të vetë industrisë.
Rregullore nr. 4, datë 08.02.2007	Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit	Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekuilibrit për aktivitetin e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe të respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikeqyrese.
Rregullore nr. 5, datë 08.02.2007	Mbi përmbajtjen e programit të risigurimit të shoqërive të sigurimit dhe afatet kohore të paraqitjes pranë AMF-së	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat bazë për hartimin e programit të nevojave për risigurim për çdo vit financiar të shoqërisë së sigurimit.
Rregullore nr. 6, datë 08.02.2007	Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në AMF	Objekti i kësaj rregulloreje janë rregullat e vendosura nga AMF për mënyrën e raportimit të shoqërive të sigurimit.
Rregullore nr. 7, datë 08.02.2007	Për ekspertët kontabel të autorizuar të shoqërive të sigurimit	Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktohen kriteret dhe procedurat për shoqëritë e ekspertëve kontabel të autorizuar, që do të emërohen nga shoqëritë e sigurimit pas aprovimit nga Autoriteti i Mbrojtjes Financiare dhe përmbajja e raporteve të kontrollit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabel të autorizuar. Ndryshimet konsistojnë në periudhën që një shoqëri ekspertësh kontabel të jetë jo më e gjatë se katër vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj.
Rregullore nr. 8, datë 08.02.2007	Mbi bazat, metodat e llogaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike	Objekti kësaj rregulloreje është mënyra e llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve matematike nga shoqëritë e sigurimit.
Rregullore nr. 9, datë 08.02.2007	Mbi bazat, metodat e llogaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetës	Objekti kësaj rregulloreje është mënyra llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetës nga shoqëritë e sigurimit.
